# Grup Autorësh

## PARNASI ME AROMË GJILANI

*(Libër i përbashkët poetik)*

**Shtëpia Botuese**
**BEQIR MUSLIU**
**2012**

* * *

**Shtëpia botuese**
BEQIR MUSLIU
Biblioteka ORFEIANA
**Editor**
Sabit RRUSTEMI
**Lektore**
Lumnije Morina
**Kopertinën e realizoi:**
Kushtrim Simnica

U botua me financimin e vetë autorëve.

Në vend të parathënies

* * *



Mirko Gashi

## URA E MASKATARIT

Ilan, ilan –
na quanin asokohe
në Gjilan
e ne
vërtet
ishim astritë
nëpër pyje
lindur e rritur

S'ndodhte kjo në teatër
ata
pa maska të arit
kudo nëpër Karadak
derdhën gjak
në çdo vatër

Shkrepnin vetëtimat

S’ndodhte kjo në teatër
trishtoheshin jetimët

rrufetë shkretonin
mal e fushë
ujin turbullonin
një vetëtimë
një rrufe
një lis për toke
një rrudhë
e nënës loke
trishtim – qumësht
për çdo jetim

Me dekada e tëhu
në këtë urë
kokat
na ngulnin në hu

Kjo urë urë
s’u ndërtua me gurë
po me lisa të prerë

Pas çdo lisi të prerë
zgjohej nga një erë
më parë stuhi
e pastaj puhi
që ndjell pranverë

Ilan, ilan –
na quanin asokohe

në Gjilan
e ne vërtet

ishim astritë
nëpër male
lindur e rritur

Në bebëzat
e të parëve të mi
u zgjua e bardha agmi
pushka krisi
u mboll lisi
u zhduke ferri
lëshoi kushtrimin
Idriz Seferi.

**Albinë IDRIZI**

E lindur më 6 maj 1966, shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Gjilan. Fakultetin e Filologjisë, drejtimi Letërsi dhe Gjuhë Shqipe, në Universitetin e Prishtinës. Prozën e parë e boton si nxënëse e shkollës fillore më 1980 në revistën për fëmijë "Pionieri".
Deri më tash ka botuar:

"Heshtja e mbarsur", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1997
"Ëndrra me ylbere", poezi për fëmijë, 2007
"Hijet e kullave", roman, Rozafa, Prishtinë, 2009 (I përkthyer dhe i botuar edhe në gjuhën rumune po këtë vit).
"Dashuruar në diell", poezi, Faik Konica, Prishtinë, 2010
"Pergamenë e gjallë", tregime, Beqir Musliu, Gjilan, 2011
"Orbita e fjalës", përzgjedhje poezish në katër gjuhë (shqip, anglisht, greqisht dhe italisht), Pegasi, Tiranë, 2011.
Është përfshirë në antologjitë poetike:
"Templul Cuvantului" (Tempulli i fjalës), në gjuhën shqipe e rumune, Bukuresht, 2009
"Antologija da associacao internacional poetas del mundo I, II", 2011
Disa nga shpërblimet letrare:
Medalja e Argjendtë për Poezi nga Akademia Evropiane e Arteve, në Gembloux afër Brukselit, maj 2010
Çmimi Special për romanin "Hijet e kullave", nga Lidhja Ndërkombëtare e Poetëve, Shkrimtarëve dhe Artistëve "PEGASI" Albania, 2010
Krijuesja më e Dalluar , KK i Gjilanit, Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport, 2010
Është anëtare e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, Akademisë Evropiane të Arteve, Lidhjes Ndërkombëtare të Poetëve, Shkrimtarëve dhe Artistëve "PEGASI" Albania,

dhe nënkryetare e Ars Klubit “Beqir Musliu” në Gjilan.

## MOMENT

Në pjatë kohe servir veten
Zbukuruar në dekorin e kopshteve
Që ushqeva me lëkurën time
Krojeve që në djersën time shuan etje
Fjalë, buzëqeshje, prekje...
Çastet ngopen e rriten sakaq
Në ditë, javë, muaj, vite,...
Përbindësh me barqe zerosh
Të pambaruara
Ndërkohë që unë i këndoj
Vetes nën zë
Ninullën e të vdekurit bukur
Pa e kuptuar
Nga e kisha mësuar.

## KUJTIM
(Tim ati)

Në pllakën e mermertë
Të varrit tënd
Sot u pashë si në pasqyrë
Unë, grua e martuar
Gëlltitëse pasthirrmash
Që klithin nga trupi, nga sytë
Nënë e duruar
Që me qindra herë

Përplaset, rrëzohet e ngrihet
Në dy fëmijë.
Por jo! Në gurin e akullt
Kujtimesh të dërsirë
U duk ajo -
Vogëlushja me piptha
Në flokët e zi
Ulur në prehrin tënd
Si atëherë kur i mësoje
Infinitin në dashuri.

## UNË TË DUA

O qenie e brishtë
Prej njeriu
Që aq ëmbël di t'u hidhërohesh
Gjërave të vogla, të imta të jetës
Kur bien mbi ëndrrat tua
Si guralecë rrëshqitës
Shkëmbinjve të lartë
Të cilët nuk kapen dot
Nga shikimi yt
Dhe shpeshherë i trembur
Godet në vend të përqafimit
Kafshon në vend të puthjes
E ik, ik diku larg vetes
Strukur në një fytyrë tjetër
Me ehun e piskamës
Më të lashtë se sanskritishtja
Që të tradhton nga pas
Unë, gjithsesi, të dua!

## DASHURISË

Në kërkim tëndin
Prekim gjithçka
Më parë se ty
Përplasemi, lëndohemi
Si në errësirë
Kur kërkojmë dritë
Ndaj, më duaj
Dhe të verbër, o shpirt
Në mos, ma hiq
Imazhin tënd nga sytë
Dhe flake tutje, tutje
Andej nga nuk kaloj përditë.

## ĒNDRRA

I dashur, çfarë pe ëndërr
Kur mbrëmë qeshe në gjumë
Lojën që bënim si fëmijë
Puthjen e parë
Apo vallëzimin e çmendur në shi
E di, ka akoma
Ma thuaj, cilado të jetë
Çfarë pe ashtu ëndërr
Kur mbrëmë aq ëmbël
Qeshe në gjumë
Veç mos thuaj, të lutem
mos thuaj kurrë -
Se nuk isha unë.

## VJESHTA

Dhe ja ku u takuan
Dhimbjet tona përsëri
Një grua dhe një vjeshtë
Mbuluar me petkun e pjekurisë
Tuat gjëmime strukur thellë
Mes ofshamave të mia në gji
E shiut ia kthej fytyrën
Pa dashur t'ia di
Cilat nga pikat që lagin mallin tim
Pikëllimin e kuqërremtë në ty
Janë lotët e mi.

## THIRRJE NGA BRENDA

E kotë të shtiresh
Pjesë e një alegroje të kohës
Kur përbrenda gjithmonë të fton
Një harfë Orfeu
Me miliona vjet drite rrugë:
Eja
Vetëm poetët kanë
Të drejtën e zhbirimit
Nëpër tejbotë
Atje, ku arkeologjia e fjalës
Është aq afër Zotit
Vetëm ata munden
Të flasin me yjet, bimët, shtazët
Të fluturojnë qiellit pa krahë
Të kalojnë detëra pa u lagur

Të zbërthejnë enigma perandorësh
Të këmbejnë mrekulli profetësh
Të dëgjojnë për çdo natë
Rrëfimet e Sheherzades
E t'i përvidhen Kreontit
Sa herë duan të kalojnë matanë
Pastaj prapë, si asgjë
Të kthehen po aty ku janë
Eja
E kotë të shtiresh
Kur përbrenda një pastoraleje shpirti
Ngarkuar me trastën e absurdit mbi shpinë
Gjithmonë ndjek një zë
Pas të cilit, si në përrallë

Mbeten thërrmijat e misterit-
Cila nga ne është vërtet gjallë?!

## PRANVERA ËSHTË GRUA

E ndjen
Gjakun si lëvrin
Damarëve të tokës
Kur shpupurish ëndrrat
Kujtimeve rrënjë
Për flladin që puth gjethet
Për shiun që lan petalet
Për rrezet që ngjyrosin shikimin
Dhe gjithçka ngjan
E ngrohtë
E ëmbël
Për të qenë e dashur

Mos u çudit, o Diell
Nëse prapë e sheh duke qeshur
Sikur të mos kishte qarë kurrë
Të flasë
Të këndojë
Të dashurojë
Sikur të mos kishte vdekur kurrë.

## PEIZAZH FËMIJËRIE

Në krahë malli
Kthehem të shëtis peizazhit të vjetër
Varur në vite kujtimesh
I pandryshuar
Me të njëjtat gjëra fëmijërore përreth
Lulet, barin, shkopin magjik të dëshirave lodër
Librin e përrallave më tej
Mbi hulajën e drunjtë mbështetur
Të gjitha, të gjitha po aty
Njësoj ishin
Vetëm unë isha bërë tjetër.

## PROFECI NJERËZORE

Në fillim do të të rrahin erërat e kohës
Nga të gjitha anët (për të cilat ti as nuk di)
Pastaj dielli do të përkujdeset të krijojë
Me shqetësimin e ngrohtë mburojë indesh
Për shpirtin tënd që syve të botës derdhet
Dhe gjithkush merr ngjyrë a shije pas qejfit të tij.
Asgjë s'do të lënë - gjithçka do të mbetet.

Dhe, kur krater i shpërthimit mbyllet i tëri
E përreth kureshtja heshtet si bishë e ngopur
Ti do të ledhatosh fshehurazi në lëkurë vulën e dhimbjes
Kur e ndjen dhe me ndjenjën e saj rri
I lumtur që përbrenda teje gjallon akoma plaga
E domosdoshmja jote që të bën Njeri.

**Avni Rudaku**

Avni Rudaku është lindur më 10 nëntor 1984 në Gjilan. Përfundoi studimet universitare dhe pasuniversitare për psikologji dhe sociologji në Universitetin Publik të Prishtinës. Rudaku ka botuar këto vepra: "Poezi pa frymë" (2010) dhe "Pa frymëzime" (2011). Është kolumnist i rregullt në shtojcën për kulturë të gazetës së përditshme "Kosova Sot". Rudaku njihet si studiues i shkencave sociale, publicist dhe si vështrues kritik i arteve pamore. Punoi si asistent i ri për psikologji në Kolegjin Universitar "Iliria" dhe si zyrtar për hulumtime shkencore në Institutin "Victory" të Kolegjit Universitar "Victory" në Prishtinë.
Jeton dhe vepron në Gjilan.

# BOTË

Botë, pse ndjen aq shumë nevojë për gjak e ar të zi
Ti nuk ke kohë të ndalesh se sondat në Mars,
janë duke kërkuar ndonjë krijesë të gjallë…
A e di ti që nuk ia ke gjetur ilaçin shumë sëmundjeve
e akoma të vdesin njerëzit nga SIDA, virusi i Nilit Perëndimor…
Botë, plot gra të bukura e nëna të mrekullueshme,
kanë ikur nga kjo botë prej virusit përbirues në gji
Botë, sa shumë varfëri ka mbi ty edhe pse ka mjaft nën ty
Botë, afrikanët kanë diamantin dhe shumë prej tyre vuajnë për bukë të gojës…
Botë, pse vriten foshnjat në duart e nënave nga industritë e armëve të shteteve paqësore
Pse je aq barkmadhe për ishujt e vegjël në cep të hartave të gjakut,
E në anën tjetër na thoni se kjo mendësi për tokë është tejkaluar
Pse botë lejoni krijuesin e robotit të kacafytet me prodhuesin e çadrës e të letrës
Pse botë po frikësohesh e po çudit njerëzit me Iphone 5,
E nanoteknologjia ka trokitur në dyert tona

Botë, që s'ndryshon e s'heq këto marrëzi sa më shpejt,
qiju.
Botë, te ne kur themi "Qiju!"
E kemi fjalën: "Sytë s'po duam të t'i shohim më!"
Se u merakosëm mos po mendoni që po duam t'ju themi të shkoni të kënaqeni diku!

## FUNDI I BOTËS

Fundi i botës.
Fundi im.
Tek e fundit.

## DEMBELI 21

Ha
Pi
Rri
Kyçu online
Shëtit nëpër profile të huaja
Kënaqu në botën e fotografive
Njeri,
ti je i dehur.
Prej teje s'ka shpresë!

## I KAM PARË NË INTERNET

**I.**
Një ditë e refuzova Zotin dhe krejt veprat e tij

Pas pak ditësh breshëri ra mbi mua
Sot e asaj dite ne jemi në paqe me Zotin:
e mohoj në motin me diell
gjatë vjeshtës bëhem besimtar i thellë
Se Zoti ka kokrra që më gjuan nga lart
Nuk jam budalla ta thyej kryet tim
Jam besimtar vjeshte

**II.**
E kam parë bizonin e plagosur para mijëra viteve në shpellë
E kam parë demin hyjni në skulptura të Egjiptit të lashtë
E kam parë hebreun duke ia hequr kokën zogut me briskun në dorë
E kam parë "Qengji i Perëndisë" – emrin për flijimin e Krishtit
E kam parë myslimanin duke prerë delen për Kurban Bajram
I kam parë me dy sytë e mi
Në internet.

## FRYMËZIMET PO SHKOJNË TE SECILI

Po të isha muzë,
kurrë s'do ta vizitoja ndonjë poet që nuk e dashuron njeriun
E kisha vizituar,
por kurrë nuk e kisha frymëzuar.
Kurrën e kurrës.
Frymëzimet po shkojnë te secili njeri
Turli avdallit

Lëre pashë Zotin!

## NE JEMI SHUMË TË LASHTË

Egjiptianët kishin sfinksin,
rojën e tempullit të faraonëve
Me trup luani e fytyrë njeriu
Para piramidave.
Mrekullia e botës.

Ne kishim besheretin e improvizuar si robot,
rojtarin e kallamboqit prej sorrave të zeza
Në të lashtat tona.

Ne jemi shumë të lashtë,
në të lashtat tona.

## KUR JE LARG KREJT NDRYSHOJ

Ku të zë kam për të përqafuar e shtrëngar pa
këqyr para e mbrapa
Kam për t'i veshur pizhamet e tua të kuqe
natën vonë me atë lepurin
Kam për ta puthur atë fytyrë të lëmuar që të
mërdhezet në dimër
Kam për të paramenduar për secilën të
mëshuar në qosh të pllakave
Kam për ta rritur syrin të më shohësh më mirë
edhe në të qorrofsha
Kam për t'i zvogëluar laprat e veshit të dëgjosh
më pak fjalë të rënda

Kam për të shikuar më shumë shfaqje të ta shoh
lojën ty jashtë skene
Kam për ta pirë gjakun për së gjalli
Kur të kam afër mos u tut se s'jam aq psikopat
sa në largësi

Kur je larg, krejt ndryshoj
Kur më vjen afër, jam një djalosh i mërzitur
Ama kënaqem veç që ekziston

Sall kënaqem që ti ekziston diku

## QIELL I PAFUQISHËM

Qiell i ngrysur pse po prishesh në fytyrë vetulla
qerpikë
Hajde lëshoje atë shi që është lot gëzimi çka po
pret
A pak po të duken njerëzit këtu poshtë të
dëshpëruar?
E ti vetëm po ndez zjarrin pa nevojë dhe nuk po
shuan etje
Pse nuk i jep ide këtij vendi qysh të ndryshojë?
E t'i përngjajë shtëpive të afërta me ne

A nuk mund t'i bashkosh bile dy a tre yje e t'i
lidhësh nyje?
E të na ndriçosh të ecim përpara pak më shpejt
E ti ke me bollëk diej qysh na ka thënë edhe
mësuesi i astronomisë
Keni rrugë krimbvrimash përplot e s'kujtohesh
të na bëni ndonjë fole atje

Pse e prishni motin brenda ditës e nuk
përkujdeseni për njeriun?
Bile edhe kafshët e bimët janë të zhgënjyera në
ty
Ne sa herë që jemi të zënë ngushtë në tokë
ngremë sytë lart kah ti
Ama edhe ti shfaqesh arrogant sa të duash
Në praninë tënde janë zhdukur dinozaurët prej
gurëve tu

Në sytë e tu kanë punuar skllevërit punë të
rënda për tempujt e princërve idiotë
Nga duart e tua kanë rënë copëza të mëdha dhe
na kanë rritur nivelin e ujit
Nga britmat tua kanë dalë zhurma misterioze
që kanë shqetësuar nënat shtatzënë
E s'kanë pushuar celularët në orën dy të natës
prej frike atë mesnatë
Janë gjymtuar fëmijët në fusha të hapura të
obduksionit
A s'të vjen turp prej kryqëzatave, Tivarit,
Srebrenicës, Prekazit, masakrës së Gjilanit…
Pse nuk i mbrojte dy zogjtë e tu të lartë që
puthiteshin me ty më 11 shtator,
pavarësisht se kush i gjuajti me llastik?!

O qiell nuk e di pse po kërkojmë të jeni i
mëshirshëm!
Po të kishit ju fuqi do t'i ndihmonit edhe
vetvetes
S'kishit pasur përplasje gurësh me bisht e pa
bisht atje në gjirin tënd

S'kishit pasur goditje forcash në hapësira të lira kozmike
Qiell i pafuqishëm!
O qiell i pafuqishëm, e di që keni vuajtje të mëdha edhe ju
Se nuk po mund t'ia bëni çarenë as vetvetes

## MONTAZHI I NJERIUT

Jam i nervozuar deri në skaj të prodhimit hormonal
Më pengoi taksisti që qeshi nga nervoza e pritjes sime
Tellalli më shkatërroi me lajmin e asteroidit trashaluq
Notoj në *google,*
në detin e mishmash peshkaqenësh e peshqish
Po më hanë zhytësit me citime e pa citime
Kam humbur rrugën për të vërtetën
E zbulova teknologjinë
Ata idiotët që i ndërseu *Dostojevski* më poshtëruan me montazh
Ata lugetërit e Silikonit kanë shpikur *fotoshopa*,
për të ndërhyrë në fotografinë e rrudhave…
Me të kup që teknologjia veç po më huton për të vërtetën
e shpresuar për gjetje me mijëvjeçarë…

Pse nuk vjen një ditë kur e gjej të vërtetën,
dhe të më pushojë kjo kureshtje e sëmurë…
Pse nuk qëllova të jem bariu i Opojës,
të bie në paqe përsëri me natyrën

Të bëhem pagan a idhujtar i mallkuar nga monoteizmi…
Më kupi ky besim, që s'po besoj…

Pse nuk kthehet sundimi i bujqësisë
E të kënaqem me bujqit që punojnë ditën,

e pushojnë natën…
Pse nuk linda në qendër,
e të kisha një dyqan me qira
Të isha bos i bosëve,
e të flas për pushime tre muaj para korrikut të nxehtë
Pse jam në këtë atdhe,
që e dua shumë…
E nuk mund të eksperimentoj bile pak,
që ta braktisi…
Po të mos e doja do të rrezikoja…
Me të kup,
kur më kërkon diçka të vogël
E nuk klikon në *google wikipedi youtube*
Sot punohet vetëm aty ku ka *wireless*
*Google* e meshkujt e dikurshëm janë bërë njësoj
Kanë nga dy toptha si dy *bole*
Duhet të kesh *bole*, për t'i marrë sa më të përzgjedhura informacionet
Nuk lexohet çfarëdo sot.

## MË THA NJERI

Më tha njeri që mjedisi po shkatërrohet
Se politika po fëlliq edhe gruan e bukur

Më tha njeri që po ik,
e ti nuk shkove akoma
Më tha njeri që ti po kallesh pas meje,
e ti nuk u kalle.

Më tha njeri që s'po gjen njerëz me ideale,
e ti vërtet s'kishe gjetur
As nuk po plakesh
Se po e shoh që zhurma s'po të pengon

Më tha njeri që njeriu plaket,
vetëm kur vjetrohet në vullnet
Në shtysën për të gjetur kuptim,
mbi jetën

Më tha njeri se jam bërë si luan.
Se qeni po kafshon sot edhe të zotin e shtëpisë,
i kishte thënë në sy njeri
More, më tha njeri po të them!!!

E ky njeri për besë nuk ekzistonte askund

**Aziz Mustafa**

Aziz Mustafa u lind më 24.12.1967 në fshatin Malishevë të Gjilanit, është mjek dhe poet shqiptar. Aziz Mustafa shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb të Kroacisë, kurse specializimin për otorinolaringolog-kirurg të kokës dhe qafës në Prishtinë, Insbruck dhe Strasbourg. Punon si specialist ORL në QKU në Prishtinë. Ka publikuar punime shkencore në revista ndërkombëtare të otorinolaringologjisë. Është magjistër i shkencave mjekësore që nga viti 2005, kur ka magjistruar në temën mbi komplikimet e pezmatimeve kronike të veshit të mesëm me kolestatomë. Është një nga themeluesit dhe anëtar i Shoqatës së Otorinolaringologëve dhe Kirurgëve të Kokës dhe Qafës të Kosovës, është anëtar i Shoqatës Policer (Shoqata Botërore e Otologëve)dhe anëtar i Shoqatës Mesdhetare të Otologëve dhe Audiologëve, si dhe Shoqatës Ballkanike të ORL-së. Është recensent i disa revistave shkencore të ORL-së, mes tyre edhe i revistës "Laryngoscope". Publikimet e tij në lëmin e ORL-së janë të cituara në databazat kryesore të literaturës botërore si: PubMed, Index Copernicus, Scopus, Google schoolar, EBSCO, etj. Më 06.07.2012 në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Nishit mbrojti me sukses tezën e doktoratës me titull "Qasja moderne në trajtim të mastoiditit akut te fëmijët dhe të rriturit" dhe u shpall doktor i shkencave mjekësore. Pos mjekësisë, është i angazhuar edhe me krijime

letrare. Me shkrime merret që nga shkolla fillore. Shkruan kryesisht poezi për të rritur. Ka botuar 3 përmbledhje me poezi: “Pasaportë kam kafkën time”, “Jeta e re”, Prishtinë 1996, “Matja e kohës së ndalur”, Shkup, 1999, dhe "Mëso të thuash jo", Rozafa, Prishtinë, 2004. Është fitues i disa konkurseve letrare. Është prezantuar edhe në shumicën e faqeve të internetit që botojnë letërsi shqiptare. Nga viti 1999 është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Ka marrë shpërblime të ndryshme të konkurseve letrare dhe ishte pjesëmarrës i takimeve të poetëve shqiptarë në Shkup, 1999 dhe në Festivalin ndërkombëtar të poezisë “Vjeshta 2003” në Pogradec. Jeton në Gjilan.

## KRAHASIM PA KRAHASIM

(F. A.)

Dhembjen e kam si Det
mallin si Liqe
dashurinë si Lumë
vetëm ty të kam si Ty

## GJYSMË JETË

Një gjysmë jete
më iku duke bërë
mëkate
a do të ketë
edhe një gjysmë
për t’i larë ato?

## LETËR NGA ZAGREBI

Përshëndetje nga Zagrebi
nga ky qytet ku në Fakultetin e Mjekësisë
shkohet
nëpër nëntëdhjetedy shkallët e Schlosserit
tramvajet janë ende të kaltër
si "bad blue boys"-at e grafiteve
rrugëve dhe shesheve u janë ndërruar
ngjyrat e emrave
fantazma e Shuflay-it endet ende mbi katedrale
biblioteka kombëtare është
shpërngulur përtej Savës
në skedarët e saj ende gjenden Podrimja A.
Shkreli A. e Musliu B. edhe pse
Oliver Mlakari i shëtit
qentë e vet rreth të vjetrës
në sheshin e Banit nuk ka më kambistë
të egër ashtu si nuk ka as romë
a e paramendoni dot si mund të jetë
një qytet pa romë e pa kambistë
kino "Ballkan" –i është bërë kino "Europa"
në teatrin popullor askujt nuk po i shkon
zëri më mirë se Merita Junikut
në operën "Mbretëreshë Teuta"

## BANKA E FUNDIT

Shkel lehtas mbi dërrasat e amfiteatrit të djegur
dhe eja të puthemi në bankën e fundit
në orën e matematikës kur profesori i dehur

të shpjegojë për gramatikën e flokëve të prera shkurt
në bankën e fundit është skalitur
një zemër dhe gjithsesi një mbishkrim UÇK
eja dhe më gënje
për kaçurrelat që nuk janë më
mbi ballin e rrudhur eja në bankën e fundit
si atëherë kur nuk na kapte ligji i robit dhe as i Zotit
mos mu fsheh pas ëndrrës as pas telave të ndërdijes
nuk jam më ky që po shoh në pasqyrë
çdo mëngjes me mjegull shaloje së prapthi epshin e shfrenuar
nuk është turp të kesh vetëm shtatëmbëdhjetë pranvera
eja në bankën e fundit
mbi Liqenin tim mos e le borën të më bjerë

## LETËR DARDANËS

Është tmerr është më shumë se tmerr se si gjërat
e mira janë përherë të huaja

Psikoanalitikët e trentë Frojdi sidomos përherë
kanë të drejtë e ti Dard Ana nuk e do atë
Edhe unë kam filluar ta urrej shkaku yt Ti nuk i
do këto vargje edhe unë
Kam filluar t'i urrej çuditërisht po më duken
disi si pula të ndukura dhe vërtet nuk kam
dashur
kurrë t'i besoj epshit së paku jo në rastin tënd
Dardana pasha sytë e mi të përgjakur
flutura ime nuk është turp të puthësh hijet e
natës As të pështysh yjet nuk është turp besomë
Është tmerr i thjeshtë se si në mua po fiton djalli
e engjëlli po më rri strukur
në një varg që kurrë nuk do të botohet Të kam
paralajmëruar ruaju nga gjenitë dhe
budallenjtë ruaju më shumë vetes dhe mos u
fut në vorbull Marramendja është
një sëmundje e keqe më e keqe se AIDS dhe se
ethet e minjve Të merr mendtë
e humb drejtimin rrëzohesh dhe keqas
përgjakesh Të çmend e ti Dardana nuk ke
nevojë për
çmenduri më mirë çmendu në letër shkruaj
poezi të çmendur
gënje veten dhe të tjerët më lehtë e ke në këtë
botë më së miri kalojnë rrenacakët hajnat dhe të
pafytyrët këndoje përditë “Yesterday“ Përherë
do të ketë një dje
Për një nesër nuk jam i sigurt këndoje pra e të të
sjellë në një pikë
dhe në një vend të caktuar ku ne nuk kemi qenë
kurrë kanë qenë shpirtrat tanë

Kanë qenë fëmijët tanë kanë qenë shpirtrat e prindërve tanë
djalli e marrtë vetëm hijet tona kanë qenë të betohem
për sytë e mi nuk do të ketë kurrë më sot
Ekzistojnë vetëm nesër dhe dje, e dje do të jetë
dymijë vjet më parë nën një dardhë të Dardhanisë
e ngufatur nga terri e unë e ti Dardana
do të jemi të zhbërë një hiç eterik do të jemi
tmerrësisht të lirë nga njëri tjetri
padurueshëm të lirë

## SHPELLA

Kokën të ma presin nuk di në ishim në shpellë apo në bark të nënës
Në librat e shenjtë të pluhurosur shkruan se ne jemi krijuar nga një pikë uji që sfidonte gravitetin
në një kristal aragoniti në Kosovë
Këtu e tetëdhjetë milionë vjet jemi puthur së pari atëherë kur nuk ekzistonin as puthje as dinozaurë as pika gjaku
Vetëm dielli ishte në zenit si sot dhe pezull mbi ajrin tim më mbushje qenien time e unë të mbarsja me shi
Ende nuk ishin zbuluar thikat kafkanat dhe buzëqeshjet e shtirura
As edhe një akord tjetër nuk tingëllon kështu në një kristal të blerë me para të huazuara
Punë e madhe pse moralin e kishin marrë më vete bashkëshortët besnikë dhe laviret

Unë dhe ti ishim ëmbëlsisht të çmendur
shtrëngonim duart njëqindepesëdhjetë mijë vjet
para Romeos dhe Xhulietës për vetëm pesë cm
largësi
Pallavra shpjegimet e spelologëve
Unë zemrën tënde e gjeja me mijëra km larg dhe
kthjellohesha nga aura
Pastaj të falja aragonitin tim të vetëm në shpellën
ku askush nuk dinte gjë për valët telurike aty ku
askush nuk dinte se nuk kishte forcë më të
madhe
se dashuria

## NË BOTËN E KRISTALEVE

Me Georg Traklin e shkretë hymë në botën e
kristaleve
Në një labirint krizantemash kinezisht dikush na
bënte magji
Ishte viti i dragoit dhe bollat po ndërzeheshin në
tualete të argjendta
Zonjat plaka në çanta bartnin shterpësinë
E ti Arabella më rrije mbi kokë si një re me shi e
mbarsur
Më hidhje në kokë pluhur kozmik a rërë të
verdhë stalaktite të dheut të Kosovës
(Ke të drejtë që nuk ma pëlqen poezinë është plot
tym mjegull dhe është terse)
Më rrije mbi kokë dhe shikoje thikën e re që
bleva dje për të provuar edhe vetëvrasjen kur të
më teprojë vetja

Kur nuk do të mund më të dashuroj fjalët tua të purpurta
Georg Trakli pi kafe me kipcin tim në një botë kristalesh të huaja
Ëndërrojmë dashuri me engjëj të çmendur dhe ejakulojmë kristale në blue jeans të shqyer

## ASIMETRIKE
(ALOPECIA AREATA)

Shëtit i paprerë limoni
Kungulli i egër dhe tërë barnat
E dermatologëve, akupunkturistëve
Kinezë, hungarezë, vietnamezë
Që në ndonjë përshtatje tjetër për disa cm të yjeve
Ndoshta do të kishin mundur disi të më shëronin
Këtë të mallkuar alopeci areata
Që as emër nuk ka shqip
Po që ka një asimetri për dreq
Asimetri e mallkuar që lind nga e majta
Në pasqyrë e shoh nga e djathta
Kur guxoj të shikohem me veten në sy
Kur nuk i fsheh asgjë ndërgjegjes sime
Dhe pastaj harroj a është
Mustaku im i majtë apo ai djathti
Harroj krahët e një fluture laboratori
Prerë për dhuratë të ditëlindjes sate
Krahët e një albatrosi të Boudelaire-it
Dhe kthetrat e luanit që mi përmend
Harroj se po më hanë duart të të shkruaj

Harroj bile edhe sa organe tjera teke i ka njeriu
Pos hundës dhe zemrës
Asimetri e mallkuar

## MOMENTO ME LORKËN

Zë i kujt del ashtu ylbershëm
Nga varri i humbur fushave të Granadës

Grua e pabesë tani numëron rrudhat dhe kujtimet
Hëna harron pasqyrën nën hijen e dy selvive
Një jevg pa dhëmb këput një tel kitare
Një yll me bisht merr natën në zotërim

## BARIU I VETMUAR

Grigja ime përtyp përgjumur barin e njomë
Bardhezi lëndinë e pafund bardhezi

Ai lis i madh më bën të ndjehem i vogël
Zgurrë e zezë trup i tij zgurrë e zezë

Grigja ime e verbër dëgjon fyellin tim
Gjak pikon në tingullin e ylbertë gjak

Pas secilit ylber e kërkoj një vajzë për nuse
Shpirt i vdekur jeton në këngën time shpirt

Grigja ime ngrin kallkan në apokalipsin e fundit
Zëri i fyellit tim në parajsë më vajton zëri

Një shqiponjë e hirtë në ëndërr më kafshon
Mëlçinë time të zezë mëlçinë time të kuqe

Grigja ime përtyp përgjumur amshimin
Bardhezi bardhezi bardhezi bardhezi

**Bujar Salihu**

Bujar Salihu u lind më 1972 në Pogragjë të Gjilanit. Pas përfundimit të maturës, më 1990 fillon studimet në Fakultetin Elektroteknik në Prishtinë, për shkak të gjendjes së krijuar, detyrohet të marrë botën në sy. Nga viti 1992 jeton në Zvicër.

**Ka botuar përmbledhjet me poezi:**

"Në xipat e vetmisë", Cyrih, (1994)
"Më pak se jetë", Rilindja, Prishtinë, (1997)
"Skeleti i dallëndyshes", Rozafa, Prishtinë (2002)

Pos poezisë shkruan prozë e publicistikë letrare. Është prezantuar në disa antologji e prezantime letrare në gjuhën shqipe e gjermane, fitues i disa çmimeve letrare në Zvicër. Është përkthyer dhe botuar në anglishte, gjermanishte, frëngjishte, rumanishte etj.

# TRILOGJIA E NJË ANKTHI

## 1. NAISUS

Aty nisi diçka e keqe dhe pastaj e keqja u rrokullis tatëpjetë
Naisus thanë dhe ikën, mbeti Nishi
U shkund rënd e keq deri në jugun e vet kobzi
Tre lumenj ndërruan kahet dhe historia u shkrua keq
Naisus mbeti nisje e përdhunshme, rënie e Mollës së Kuqe
Ëndërr e atyre që s'u kthyen më…

## 2. SHKUPI

Ti ke mundur edhe të pushkatoheshe nga llahtaria
Qytet i bardhë mbështjellë në të zezë morgu, sfinë vetëtima
Po emri yt s'ka mundur të prehet me të rëna shpate
Mbi Urën e Shenjtë dënesje trëndafilash dhe Vardari përlotshëm ngrin
Shemben gurët, kupola bie, unazë e kobshme kurora jote
Sa larg të kam sonte, dridhur lexoj pagëzimin e huaj
Mos lë o Zot që Shkupi të na bëhet Naisus

## 3. MITROVICA

Të ruajnë ushtri të huaja dhe ushtri të huaja të ndajnë
Edhe këtu një urë që e shenjtë nuk është
Një lum që përpin fëmijët, dhe si gjarpër në qafë na shtrëngon
Një gjarpër që përçartur varret dhe nëntokën ha
Diell i përmbysur, liria varg i përhirtë
Gdhendur trishtimit, me njërin sy s'po të shohë më… Mitrovicë!!!

## ËNDRRA PËR ITAKËN

Po të shkruaj për natën e përmbysur nga yjet
Peizazhin e këputur si degëz ulliri
Edhe ca shenja të harruara që po më rishfaqen
Si në një ëndërr të operuar
Vetëtima e vetmisë po bie si terr i kalbur
Ca trëndafila në një udhë të huaj
Nesër e dua Itakën time, varrin mbi Itakë e dua

## SHI BIE MBI EMRIN TIM

Të enjten rrokulliset vdekja, pastaj pushkatohet edhe një poet
Qafës së klithjes cengë lëkurash merimangë e shtatë fytyrës
Varrit të enciklopedisë hedhim krip dhe guralecë, ecim pa rrëshqit
Magjia e kafshimit prapë mallkim për portretin e verdhë

Dhelpra dhe dhëmb të palarë, zi si koha dje më kafshojnë
Vegime të fjetura, mashtrim apo ëndërr e huaj
Imazh nga po ai burg, arkivol rrudhash, thinjash dhe mërzi
Stoliset nisja jote e vonë, hija e zezë dhe prapë je ti

Pezull, çast litari, sy të përshpirtshëm teh vetëtime
Kur e keni parë të thyer qiellin pse jeni ndier mirë
Nuk e di si keni mundur të putheni gojë më gojë
Në darken e të shtatëve vishnit lëkura të huaja pa faj

Thatë është në këtë moçalishte harrimi të pistë
Ju shaheni sa herë ju është kujtuar emri juaj
Sipër mbrëmjesh terri nuk di kush rron

Shi bie mbi emrin tim, pastaj shqiptohet një dënim…

## TË KESH ATDHEUN TËND

*(Babës plak në ditën e 17-të të muajit shkurt)*

Të shihja vrimës së vogël si nga fundi i një oqeani të trazuar
Të shihja ëndërr dhe në mëngjes nuk dija ta tregoja
Ëndrrën që kisha parë

Fotomorganë, përfytyrimi im për Atdheun

Prisja të binte shi të më shkrinte kurorën e akullt si qefin
Të vinin flutura Atlantiku, për t'i dhënë shpirt qytetit tonë tufan
Të shfaqeshin engjëjt, litarin nga qafa të na e zgjidhnin
Ëndrra ime e bardhë mbështjellë me të zezën shami...

Pëshpërima e luleve të hekurta, valle e ngrirë mbi pullaz
Prapë etja, nesër mund t'ua gjejmë domethëniet betejave
Mbrojtja e Atdheut shenjë e mirë për kalimin në kohë tjetër
Natës së madhe të triumfit, s'mundnim pa pëshpëritur emrin tënd

Baba Plak qante si fëmijë pa mundur të pyes
Në ja kemi zhveshur magjinë e përplumbtë Atdheut

Urdhëroi edhe një herë t'i numërojmë varret, të shfletojmë historinë
Nesër vjen e diela, drita e Zotit në anën tonë...

## KËNGA E SHTATË PËR QIELLIN

Nesër mund të më gjesh në vetminë e ngufatur nga hija

Aty si gjithmonë jam ulur pranë njerëzve të
huaj, në përpjekje për të përbirë fluide vreri
Si zakonisht në stinën time mund të fluturoj pa
pyetur askënd
Po ti eja sepse edhe nesër nuk do të fluturoj,
Se vetëm edhe nesër pa atdhe jam...

Nesër mund të bëhet vonë, prandaj po nisem
sot, sot ti mos eja
Ne vetëm një pikë të huaj, si kërthizë të lidhur
ëndrre kemi
Në qoftë udha ime natë, unë vijë me kalin e
bardhë,
Hirësi, nesër fillon ringjallja
E nesërmja fillon fiks në orën pesë e dy minuta,
kur edhe lind dielli

Sa mirë është të kesh Atdheun tënd, dhe një
diell që lind ekzakt
Sa shumë na ka dashur robëria dhe prapë të lirë
jemi, shpirti yt ndjesë pastë
O Faik Konica...

## VETËTIMAT E NJË QYTETI

Këtu, qyteti përvajet nga vetëtimat e ndezura të
rrethimit
Kur nga vetja ka hequr zinxhirë të mërzitshëm
të imazhit mort
Për të devotshmen, ka klithur si fëmijë i
braktisur hakmarrjesh
Me flokë gjarpri ka lidhur vdekjen fizike

Vrimave të zërit e diela kryq arrestesh e bardhë
s'është këtu
Thonj fantazmash gërvishtin fytyrën e guximit
të Ikonës
Sy të plumbtë vjedhin Thesarin nacional të
kristaleve
Tymi kollitet, muzika e shurdhër dhe një ujë i
turbullt me maskë
Në këtë qytet ashti i hekurt i një perandori
turpshëm kalbet
Lëkundjet e purpurta të lumturisë, fatamorganë
buzëqeshjesh janë
Këmbë muzgjesh shkelin si shtrëngatë mbi
tempullin e hyjnive
E flatra qyqesh puthin sarkofagun e mbyllur të
Apolonit
Askush nuk ngopet me shijen e bukur të
lavdisë
Duar meskine shtrëngojnë gjinjtë e shtrydhura
të stinës
Këtu, çdo ditë gurgullojnë fjalime lidhvdekur
gjelash
E askujt nuk i shkon në mendje se e shtata
biblike është...

## RROTULLIM

Në fundin e parë të rrotullimit tim
Rreth boshtit tënd
isha zog i plagosur lehtë

Në fillimin e rrotullimit të fundit
Me lëvizje somnambulë
U bëra autor i vetëplagosjes së rëndë
Në fundin e rrotullimit të fundit
Jashtë gjendjes somnambulë
U bëra autor i vetëvrasjes së parë
Tani pas çdo rrotullimi
Fillon një rrotullim i ri
Më shumë se somnambul, më pak se jetë
Më pak se jetë
Mund të (mos) jetë jetë

## NDODH

Po të mos ndodhte
kështu si ndodhi
sigurisht
se do të ndodhte ndryshe
Ndryshe do të ndodhte
sikur të mos ndodhte
kështu si ndodhi
Ndodh të ndodhë kështu apo ashtu

## ANATOMIA E KËRKIMIT

(Tim atit)
Kam shëtitur qiellin
Yje yje yje
Vetëm ty nuk të kam parë
Ti paske ikur diku, larg në planetin blu,
Pa përfunduar shënimin për aritmetikën e etjes

Matjen matematike të frymëmarrjes së dheut
E paske shtruar si ekuacion me vetëm një të panjohur,
Po nuk shtrohet udhëtimi jetësor brenda një kuadrati
Mbyllur në plagën e teorisë algjebrike të dritës
Në fushë shahu me mbretëreshë të zënë rob
Kuajt kah i ke nisur Ati im

## HIMN PËR KËNETËN

Kur t'i nxjerrim këmbët nga balta
Shpirti i thur himnin kënetës
Në mrizin e hijeve na zë gjumi
zgjohemi veç disa ditë para vdekjes
marrim frymë thellë, konfrontohemi me vdekjen
Dhe vdesim heroikisht...

Të nesërmen fillon ringjallja
Ngrihemi si rëra e tronditur në shkretinë
Për inat të 1999 fillojmë ta hamë njëri-tjetrin
ua gërryejmë mishin kockat ua marrim për stoli laboratori
në Muzeun e kanunit dhe hakmarrjes gjendet i varur Gjergj Kastrioti - Skënderbeu...

**Fehmi Ajvazi**

Fehmi Ajvazi u lind më 23 shtator të vitit 1962, në Gjilan. Shkollën fillore e mbaroi në Zhegër, kurse të mesmen (drejtimi i Kulturologjisë ) në Gjilan. Studioi shkencat juridike. Ndërkaq, ka mbaruar shkencat politike në Universitetin e Prishtinës, si dhe ligjëratat për magjistraturë në drejtimin Administrativo-Politik në Universitetin "Dardania" të Prishtinës. Në vitin 1988, pranohet në cilësinë e gazetarit në gazetën e studentëve të Universitetit të Prishtinës, deri kur "Bota e re" u mbyll, ashtu si edhe Universiteti i Prishtinës nga regjimi titist - jugosllav, në shtator të vitit 1991. Si poet dhe gazetar, z. Ajvazi bëri emër në këtë kohë. Gjatë viteve 90-ta e këndej, z. Ajvazi botoi me dhjetëra e qindra shkrime, vjersha, ilustrime, reportazhe, komente etj. Ka qenë bashkëpunëtor, edhe i shumë gazetave të kohës. Në vitin 1994-95, z. Ajvazi punoi sërish në gazetën "Bota e re" në cilësinë e redaktorit në rubrikën e kulturës, kurse nga viti 1995 -99 punoi si gazetar në të përditshme "Bota sot" që botohej në perëndim (Zvicër).

Pas luftës ka punuar për disa vite në cilësinë e gazetarit, në gazeta dhe revista të ndryshme. Në fushën krijuese, në vitin 1995, z. Fehmi Ajvazi botoi librin e parë poetik me titull "Porta e hapur", kurse një vit më vonë, botoi librin dokumentar "Vite të stuhishme – kujtime mbi ngjarjet në universitet". Në vitin 2000, botoi librin dokumentar "Portreti i luftëtarit të lirisë", dhe po këtë vit, librin tjetër dokumentar "Programet e partive politike shqiptare të Kosovës". Ka botuar pastaj edhe këta libra: "Njohuri politike dhe juridike" (përgatitje: 2003), "Spiritus" (poezi: 2007), "Njohuri politike dhe juridike" (ribotim i plotësuar: 2007), "Teknologjia e mureve" (analiza, komente, studime: 2008), "Komploti" (analizë: 2011), "Dita 24- Kronikë për Kosovën" (publicistikë letrare: 2012).

## VJERSHË PËR KOHË TË VERDHA

1. (Iluzioni për jetën)

Në fillim ishte drita dhe fryma jonë
Ta dini: kurrë s'shkela në sy njeriu
As në brazdën e lëruar në Shëngjergj
Në puse balte të pistë ku shiton jeta
Ora e ligë e netëve pa zogj të lirë

U rrita përgjasueshëm dhe në heshtje
Me ata që e duan zotin dhe njeriun
Në fillim kishte çdo gjë veç lirisë

Që mund të gjendej kudo dhe askund
Ishte kohë e verdhë kohë breshke
Me ritme pagane në etër dhe mërzi
Sytë na verboheshin si bufit persë
Prej ngjyrave të rreme të lirisë

Dita ish plot me spiuj e lavire
Mbërthyer me trishtim dhe vdekje
Nuk lexohej Ana Franku për frymë
As Lahuta e Malcisë për rrënjë
Nga shtjella e mërzisë gjëmonte gjoli
Për jetën memece vdekja ishte zot
Ne kalbeshim: mes stinëve - mort

2. (Legjenda në diktaturë)

U rrita me forcën e dashurisë sime
Me lëng prej kripe me mollë vjeshte
Duke u fshehur në rima të përgjakura
E zogjtë fluturonin me drojë me trishtim
Dritaret e shpirtit i rrihte era e keqe
Lumturia ishte vizion festash të rreme

Ta dini: nuk thuhet me asgjë koha ime
Nuk pikturohet as nuk vihet në skenë
Nuk ka teatër t'ia përthekoj thelbin
Veç shpirti e di dhembjen nën diktaturë

Njerëz: lumturia digjej si flutura në zjarr
Kur këndonte lorëza në hije mjerimi
Shqiponja në kryq - kryqëzuar fluturonte
Te këmbët e popullit pikonte diktaturë

E kërrusej lisi nga fjalët plot mashtrim
Me temjan e përkundnin ëndrrën time

3. (Ideologjia e stepave)

Jeta ishte legjendë e zezë në kohë
E di: s'vdisej lehtë për ideale lirie
Gjithandej deri ku bren miza hekur
Në përvjetorë festash zbrisnim në log
Me shalle të kuq i lidhnim fatet tona
Ata: idealet duart lotët na i kryqëzonin
Tek e fshihnin botën e tyre monstrume
Bijtë bastard të stepave të ftohta të veriut

Liria ishte kumti ynë në gjol - rrëmujash
Andej ku vdiste pak nga pak atdheu ynë zot
Bashkë me epokat e mbërthyera në lot
Sytë na i mbulonin me imazhe të verdha
Të gjithë besonim në kohë dhe në përralla
Në përralla që ta hanin kokën për një fjalë
S'kishte qenë fjala në fillim por dhembja
Veç idealet ishin të përtejbotshme-hyjnore

Eh ynë zot: tek i fale pushtet mërzisë
S'kishte zjarr që i djeg ëndrrat e lirisë
Ëndrrat na ngjiteshin në lëkurë gishtave
Si hekur i skuqur agsholi fletët e limonit
Ata na thoshin me mynxyra e verbëri
Ata bijtë e pushtetit të zi
Edhe zoti mund të vdes yjet qielli
Veç diktatori jo: fytyra e tij prej dielli

Kështu na thoshin dhe na poshtëronin
Kështu na gëzonin dhe na trishtonin
Për një puthje kurve për një gotë uiski
Të sjellë me përdëllesë nga botë tjetër
Derisa binte shiu i vjeshtës në agim
Derisa koha e verdhë e mbulonte jetën
Në vazhdimësi të trashjes së demonit…

4. (Fotografia e marrëzive)

Në mbrëmje ktheheshim me dritëhëne
Ktheheshim nga festa e ditës së çlirimit
Në të vërtetë ishte dita e festës së robërimit
Ktheheshim nga qyteti – me pak neone në sy
Nga qyteti që dridhej prej zhganit të zi
Nën parulla politike e langonj të rinj
Ktheheshim në shtëpitë tona prej letre
Mbuluar me dhembje dhe dëshpërim
Lidhur nyje me zinxhirë me harrim

Të lodhur ktheheshim nga rruga - pluhur
Idilet i fshihnim brigjeve me luleshtrydhe
Si në legjendë atdheu përtypte vdekjen
Ktheheshim të molisur nga rruga e jetës
Ta ruanim zemrën e fshehur e të nxirë
Në vigjilje të ditëlindjes së diktatorit
Në vigjilje të festave të robërisë…

Rruga ishte e mbushur me thera e baltë
Në netët pa hënë fillonte gjuetia e re
Dhe sërish gjueti: kryqëzim e pushkatim
Me rastin e pikturimit të lirisë ndër mote

Me rastin e festave prej alte e sqote…

Kur ktheheshim e vinte mbrëmja tjetër
Në shtëpitë tona prej letre prej reshë
Hanim darkë nën dritë yjesh të përgjakur
Tutje në etër bubullonte liria e rreme

Fjala e partisë psalm vdekje në urnë
Uragan i shpifur zjarr bastard-mitik
Derisa vinte festa tjetër në vijim

5. (Romantika të befta dhe heshtje)

Nga veriu – në jug valonte flamuri i rremë
Flamuri i lirisë së shpifur në Selishtë
Pastaj nën dritën e mugët shfletoja librat
Për ta pikturuar virtualisht dashurinë e re
Dhe rapsodinë e betejave të humbura në kohë

Prindërit pinin çaj rusi nën dritë hëne
Gjyshi pyeste për shëndetin e diktatorit
A vdiq a shpëtoi pyeste: e lutej ngadalë
Lutej të vdiste për të mirën e atdheut
Medet për kohën që vjen nesër thoshte
Medet për kopenë që e mbytën ëndrrat

Ngadalë vinte e lëshohej nata flinte gjeli
Ne flinim si në ujë në tejbotë në fund të saj
Me këmbët tona lidhur në diktaturë
Kur sosej vajguri flinim ankthshëm
Nën ritmin e lehjeve të qenve
Veç ata nuk flinin e ruanin shtëpinë

Ligatinë na bëhej zemra jeta dashuria
Dita ishte e proletarëve nata e hajdutëve
Udhëheqësve s'u dilte atdheu për meze
Ne hanim fletë doktrinash me mërzi
S'kish tjetër gjë për popullin në sofër
Veç ca psalme të shpirtit të shenjtë
Që s'mjaftonin të shpëtonim gjallë
Shtëpia e lëshonte shiun frymën
Lageshin breznitë mërdhinte liria

Lageshin fletët e librave ëndrrat dashuria
Idealet tona nën ritmet pagane gjëmonin
Obelisku i lirisë digjej: librat, vaji, kripa...

Mandej: ëndrrat u kthyen në hone
Të thella sa detet e lotëve në kryqëzim
Do të shtrydhet si limoni liria bastarde
E sjellë nga viset e akullta nga stepet
Me perfiditet me copëra flamujsh të rremë
Flamuj që u vinte era mut një ditë larg

Ngadalë mërzia u bë shteg shpërthimi
Nga zemra në zemër ringjallej pendimi
Dikush tha: ky është mashtrimi - ferrnaja
Zbrisni në log se fjala po zgjohet gjoli
Se zotërat po trazohen si moti...

6. (Ringjallje në kohë)

Do të zbresim në logun e shpërthimit
Ta shtrydhim si limoni lirinë në bronz

Thoshin: gjaku i zi janë lidhni në pranga
Veç diktatori zu e të dridhej e të fshihej
Nunët e tij s'i zinte gjumi vërdallë
Derisa ai pshurrej e pastaj shtrihej
Derisa i mbaronte orët e seksit bastard
Derisa ngopej hajnisht me zemrat tona

Unë dilja mbrëmjeve të vona në lamë
T'i vështroja dritat poshtë në rrafsh
T'i dëgjoja lajmet ta kundroja kohën
Orët e përtejbotshme t'i kuptoja
Nëse pranverë kishte diku tjetër
Nëse jeta fillonte e mbaronte në Selishtë

Veç bota ish si ne-ne ishim si bota
Një ditë diktatori vdiq bashkë me lirinë
S'ish liri-ishte ai qiell pa re dhe shi
Ishte jeta jonë mbuluar me mërzi
Njerëzit u përulën qanë u veshën zi
Shkruan poema udhëtuan te varri i tij

## ATJE KU TI TASH JETON...
(Heroit)

Atje ku t'i tash jeton është mbretëri e re
Legjione të kthyera në mort-sfidon
T'u ka ringjallë jeta në të madhin atdhe
Krejt si yll mëngjesi-krejt si medaljon

Atje ku t'i tash jeton është stina me yje
Diktatura këndej ka shumë-si Akeront
Eh sa ishe këndej të mungonte ky atdhe

Bërë nga bubullimat-bërë nga gjak e lot

Atje ku t'i tash jeton është koha legjendë
Liria është punë e madhe- sa vetë jeta
Sa ishe këndej t'i thurje një eden
Për gur dhe shqiponja-për breza

Atje ku t'i tash jeton na sheh si nga Olimpi
Në mbretërinë e dalzotësve-therorë
Është bota e andejshme dhe t'i mirë e di
Po ti je atje-për ne mburojë…

## STRUKTURA E SHPIRTIT

Varka e Noas vinte e mbyllur, e lidhur
Të gjente një fillim të ri, një tokë me jetë
T'i kthehej Zotit të vërtetë…

E sillnin erërat e Diellit ciklonet e Zjarrit
Te këmbët tona të zbarkonte
Shpirtin njerëzor nga zhbërja
ta shpëtonte…

Ishte thënë të rigonte, të ringjallej
Gjaku ynë në gjenezë…
Drita kurrë mos të fikej
Nga shtjellë e natës së zezë

Hyji tha: e pafund është dashuria
Përballë çmendurisë dhe trishtimit
Përballë mëkatit dhe pendimit

Varka e Noas s'ishte mashtrim
As lëngatë rrënimi…
Toka jonë e premtuar ish
E bukur, e pafund s'i qielli…

Edhe sot: dyzim e lot derdhen kohëve
Ujët na soset ngadalë kur bota bie në heshtje
Në tundim,
Në rrënim…

Veç ti duhet të vazhdosh, të udhëtosh

Lirinë tonë gjithmonë ta bekosh
Lutjet e vjetra të gjakut njerëzor
Pafundësisht t'i bashkosh…



**Ibrahim Kadriu**
Ibrahim Kadriu është lindur më 8 janar 1945 në Zhegër, fshat i Karadakut të Gjilanit (Kosovë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, më 1959 e shkollën e mesme (Normalen) në Gjilan në vitin 1964. Studimet universitare i mbaroi në Prishtinë. Dy vjet ka punuar pedagog në

tetëvjeçare. Më 1968 ka filluar punën në të përditshmen "Rilindja", si gazetar në rubrikën e kulturës dhe reporter i lirë. Që nga viti 1973 ishte redaktor i kulturës në këtë të përditshme. Në "Rilindje" (si redaktor), ka punuar deri në dhjetor të vitit 1999 kur nisi punën (në detyrën e redaktorit), në të përditshmen "Zëri" ku edhe sot punon. Gjatë periudhës dyzetvjeçare në gazetari, Ibrahim Kadriu ka shkruar recensione për film, vështrime të ndryshme, humoreska si dhe reportazhe; shënime udhëtimesh nga vise të ndryshme të botës. Ka shkruar skenarë, radiodrama, romane, vëllime poezie. Ishte anëtar i redaksisë të revistës letrare "Plejada" (gjatë viteve të gjashtëdhjeta), kurse katër vjet ka qenë kryeredaktor i revistës argëtuese për fëmijë "Hareja" (gjatë viteve nëntëdhjeta), njëkohësisht është anëtar i redaksisë së revistës së ilustruar "Teuta". Gjatë viteve të tetëdhjeta ishte kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Romanin "Pas kthimit", Radio Tirana e ka realizuar edhe si radiodramatizim të cilin në disa vazhdime e ka emituar gjatë viteve të tetëdhjeta.

**Çmimet letrare**

Për veprimtari letrare ka marrë mirënjohje dhe çmime të ndryshme: Mirënjohje nga Festivali i Filmit, Pulë, 1975; Çmimin e Vendlindjes, Gjilan 1977; Mirënjohje nga Qendra Kulturore, Shtutgard, 1980; Çmimin e Nëntorit të qytetit të Prishtinës, 1981( për skenarin e serisë televizive "Fidani", realizuar sipas romanit "Pas

kthimit"); Mirënjohje nga Bashkësia Vetëqeverisëse e Kulturës e Prishtinës, 1984; 1985 - Çmimin vjetor "Shtjefën Gjeçovi"; Çmimin "Agim Ramadani" 2004; Çmimin "Ymer Elshani" për romanin "Çuni i kohës së Lekës", për vepër më të mirë të viti, 2007; Çmimin vjetor të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës për romanin "Kalorësi i Karadakut" 2007, Çmimin "Beqir Musliu", 2011, etj...

**Veprat e botuara**

"Netët e Karadakut", poezi (1969);
"Qyteti i luleve", tregime (1970),
"Pranvera shikon nga bregu", vjersha (1972),
"Diçka po ndodh", poezi (1972)
"E lumi rridhte", novelë dhe tregime (1973),
"Armendi", poemë (1974),
"Pas kthimit", roman (1975), ribotoi "Naim Frashëri",(1985),
"Hapësirë", poezi (1977),
"Shpëtimtarët", novelë dhe tregime (1978),
"Kohë e të korrave", roman (1979),
"Troku", poezi, (1980),
Tregime (1980),
"Kroi i ilaçit", roman (1982)
"Ethet e një dimri", roman (1983),
"Zogjtë fluturojnë vetë", roman (1986),
"Fjalori i mbrapshtë", poezi, (1986),
"Epoka në figura", roman (1987),
"Nëna", novela, (1988),
Tregime, përzgjedhje lekture (1988),
"Pastaj harrohet", poezi (1989),
"Më shumë se lojë", roman (1990),

”Qerrja e dritës”, roman (1990),
”Loja e fundit”, roman (1993),
”Përrallorja”, novelë dhe tregime (1996),
“Vite me plagë”, roman (1998),
”Spirale muzgu”, roman (2002),
“Shqiptarja e gjithë botës”, roman, ribotim i UEGEN-it, Tiranë, 2003,
“Shtëpia e fantazmave”, roman, 2004;
“Qeni me tenxhere”, poemë, 2005,
“Dy shoqe të lagjes sime”, 2006, vargje për fëmijë;
“Çuni i kohës së Lekës”, roman, 2006,
“Kalorësi i Karadakut”, roman. 2007;
“Frymëmarrje në shtjellë”, vëllim me poezi, 2007;
“Dy plus dy”, drama dhe novela, 2008;
“Kush është gomar”, poezi për fëmijë, 2010;
“Gloria në mes”, roman, Tiranë 2010;
“Largësi të afërta”, udhëpërshkrime, 2011;
“Buzëqeshje miqsh”, reflekse biografish, 2011.

**Veprat e autorit në gjuhë të huaja**

“Koprena vremena”, serbokroatisht, poezi (Veli i kohës) – (1984)
“Lekovit izvor”, roman, serbokroatisht (Kroi i Ilaçit) - (1987)
“Na ramas timp pentru sarbatori” (S’mbet kohë për kremte), vëllim poetik në gjuhën rumune, Bukuresht, 2005
“Dreni dhe Drenusha”, novelë, ilustrim shqip-norvegjisht, 2005;

**Botime të tjera**

Dhurata letrare, libër leximi për kl. VII (1987), shumë herë i ribotuar,
"555 arsye për të qeshur", libër me mahi, me pseudonim I. Karadaku (1995),
"444 arsye për të qeshur", libër me mahi, me pseudonim I. Karadaku (1997),
"777 arsye për të qeshur", me pseudonim I. Karadaku, 2010;
"Agimi i lirisë", monografi për Agim Ramadanin në tri vëllime, 2011;
"Ramiz Cernica simbol i bashkimit kombëtar", monografi, 2011.

**Prezantimi i autorit në antologjitë**

* "E di një fjalë prej guri", Naim Frashëri, Tiranë 1972;
* "Shi në një legjendë" (Kisa u jednoj legendi), serbokroatisht, Beograd, 1973;
* "Dega e pikëlluar" (antologji në italisht "Ramo Sefferente", gjermanisht "Der bekumente zweig", frëngjisht "La solitude d'une branche" 1979 dhe anglisht "The sad branch" 1984).
* "Slo po soncu" (antologji sllovenisht) (Etje për diell), botues Cankarjeva zalozba, Ljublanë 1979;
*Savremena poezia Kosova", serbisht, botues Odzovi, Bjelo Polje, 1979
* Turqisht: "Yugoslavya çardash arnaut shiiri antalogosi", botues Tan, 1979
* "Bir avuj mavi" (Një grusht kaltri), antologji, botues Yalçin Yayinlari, Stamboll 1986;

* Antologji e poezisë bashkëkohore në Kosovë (arabisht) botim në Damask, 1981 dhe Kuvajt 1984;
* Tregime (letërsi ballkanike për fëmijë) botues, Andersen, Tiranë, 1999;
* "Kosova dans la nuit", botues Editions de L'Aube, Paris, 1999
* Agim Vinca (antologji me komentime) "Këngë e hapur", botues Brezi i ri, Prishtinë, 2005;
*Ali Podrimja: "Një gur i çarë", sprovë për antologji, botues Rozafa, Prishtinë 2006, Toena, Tiranë 2005;
*Ali Podrimja: "A split stone" (anthology of poets for Kosovo) 2006;
*Baki Ymeri "Frumsetea frumsetilor" (Bukuria e bukurive), Bukuresht, 2008.

## NË TEATRIN ANTIK TË PËRBUZJES SË NJË KOMBI

Askush s'ka dëgjuar për mua,
S'ka parë as gurët e mureve të larta;
As varret, skeletet jo se jo –
S'ka njohuri kush mbi gishtat
Që ledhatojnë njësoj si të Bizmarkut
Që ngjeshin bukën dhe e hanë.
Që ngrenë gotat dhe i falen dollisë;
Askush s'di për kokën time
Për qafën që e mban atë të lodhur
Nga litarët, nga shpatat e Demonit.

Jam në planet krejtësisht tjetër:

Larg syve e mendjeve, larg botës,
I mbështjell me lëkurë delikate
Që merr nishane në çdo hap e në çdo çast,
Askush s'vëren praninë time në kohë
Në imagjinatë kam mbetur bisht e kokë
Fantazmë e krijuar në laboratorë...

Askush s'e njeh gjakun tim që rrjedh,
Krejt e huaj, i mbetur në faqe librash:
I krisur, xhind, mbi faqe tavolinash
Bilar luhet me zemrën time:
Meny e përhershme në sofër diplomatësh
Që kurrë, ama kurrë s'dëgjuan për mua,
As mbajtën ditarë që të mos rëndohet zemra
Se vetëm varret do mbushnin rrashtat
E do prishej rendi i lojës në teatër,

Në teatrin antik të përbuzjes së një kombi.

## PËRSHËNDETJE POETIT

(Takimi me librin e Dritëro Agollit "Vjen njeriu
i çuditshëm")

Më erdhe si njeri i çuditshëm në këtë natë
Në mes të mallit – siç vjen vëllai,
Pa trokitur, pa lodhje, pa zgjedhur datë,
Më hyre në dhomë krejt i zhveshur
Se gunën e kishe lënë në thera tek vije
E shallin diku, kush mund ta dijë?

Ma mbushe sofrën me kohë e metafora,

Në mes të durimit, eu çfarë shfrimi;
Me pika loti... andej kah dukej Kosova.
Poet, dhuratë e hijshme e ditës sime,
Sa vrulli, sa gazi, sa prehje e shqetësime
Këtu ku rri e më bën për pesë pare vetmia,
Ku pjell dhembja e merr frymë historia.

Më erdhe si puhia të gjeje nuse këndej,
Me vargje krushqi, dasmë e shkuar dasmave.
Të është prishur gjumi dhe ëndrra andej –
Poet, etje regjur, si të daulles ke lëkurën,
Mirë që erdhe, të m'i heqësh ca gurë
Peshë të ditës, të ngarkuar kush e di se kur...?
Poet, o, sa harqe na duhen për urë...?

Ia kam zënë pritën lodhjes, ja tek rri

Ndërroj llafe me ty, njeri i çuditshëm,
Mbush gotat me verë Kosove, të ngrehim dolli,
Të dehemi si i ka hije, kajamçe, poet –
Ta lëmë një çik anësh gjithë atë që vret
Tash kur më erdhe aq furishëm, i uruar
Të pimë për shëndet vëllai, gëzuar, gëzuar!
*1997*

## POPULLI ËSHTË FAJTOR

I shoh tek hedhin hapat të arrijnë diku
Në një adresë të ngatërruar premtimesh
Silueta që lëvizin në drejtim të brengosjes
Populli i lagjes sime
Një popull i çuditshëm

Me aq shumë faje
Kurrë i pajtuar me shpirtin:
Ai sheh shumë
Dëgjon ç'i arrin në vesh
Rob i ditës
Mezi pret natën të pushojë në ëndërr,
E t'u kërkojë falje fajeve
Vetëm pse merr frymë.

Populli është fajtor
Kurrë i liruar nga barra;
Fajtor pse i duhet të ushqejë fëmijët,
Pse beson se nesër do jetë më mirë,
Pse shikon dhe sheh zi e më zi,
Pse përcjell ditarin televiziv të mbrëmjes,
Pse nuk i beson askush
E s'di ç'të bëjë nesër
Me atë trup të tij të lodhur.

Populli është fajtor
Se emrin e vet ua ka falë të tjerëve
Të mbajnë ison e premtimeve;

Populli është fajtor

Se do strehim mbi kokë...
Kurrë nuk shfajësohet ai
Gjithmonë i ngarkuar
Me fajet pse aq shumë e do jetën
Do të ngufatet me fajësinë e vet.

# PARA GISHTAVE QË SHQYEJNË KUJTIME

Andej fjalë e nënës
Këndej fjalë e nënës
Në mes unë
Pa gjuhë
Para gishtave që më prishin ëndrrën
Që ma nxjerrin zemrën mbi tryezë
Trastën ma zbrazin
Pale mos më ka mbetur pak dashuri
Për nënën
Për të më ndëshkuar serbisht

Andej është nëna
Këndej është nëna
Në mes unë
Heq lëkurën për analizë
Lëkurë e regjur nëpër shekuj
Para gishtërinjve që mbysin kujtime
Dhe mbajnë ison
Për vrasjen e durimit
Aty pikërisht në atë mes
Ku ndërpritet frymëmarrja
Ku kalojnë në ilegalitet të gjitha dashuritë
Për nënën andej
Për nënën këndej
Bëhet procedurë e konfiskimit
E ndëshkimit të historisë
Aty
(*Mars 1996, te kapërcimi i kufirit shqiptaro-shqiptar*)

## KUR TË VISH

Kur të vish në Kosovë
Bën burrëri të jesh zgjuar
Të lëshosh hapat ngadalë
Pa lënduar rrugën në të cilën ec
Si faqe libri i pashkruar
Do kesh fatin të jesh personazh
I filmit dokumentar për lindjen
Në Kosovë çdo lindje është e para
Lindje të pangopura me dashuri

Kur të vish në Kosovë
Krejt gjërat janë në pritje
Të presin të të falen si virgjëresha dhëndrit

## UDHËZIME PËR NGRITJEN E SHTËPISË

E para e punës themeli
Pastaj gurëve si rrokjeve
T'u falet pushteti i metaforave
Mes qiellit e tokës
Shprehje përballë kohës

Vjen radha e dyerve dritareve oxhakut
Nga gjithë epika strehuar në histori
Të merren mostrat durueshëm
Shtëpisë i bën strehë mburrja

Çatia të ketë guximin
T'i dalë në dyluftim breshrit
Njësoj si edhe zjarrit nga predhat
Zjarrit të pashuar nga mesjeta e tutje
*(Maj 1999)*

## GJEOGRAFI E ETUR

Shqipëri është edhe ku s'është
Deri ku bën dreqi vezë
Se molla e kuqe s'është më e kuqe
Pa lëvozhgë ka mbetur
Në mëshirë krimbi

Shqipëri është edhe ku s'është
Me kot është ndrydhur harta
Është tkurrur atdheu në acar
Hartat mund të shqyhen

Shqipëri është edhe ku s'është
Ka mbetur aty ku ishte
Si rrëfim që nuk harrohet
Si këngë epike odash të lashta
Barrë e hijshme mbi shpirtra brezash
Për të mundur të thuhet
Shqipëri është edhe ku s'është
Mesazh i bukur për gjeografi të etur
Që më erdhi kur vargu i poezisë
I falet Çamërisë
Sikur iu fal Kosovës
Si formë më e mirë
Depërtuar në zemër

## ARRITJA NË PREKAZ

Kam arritur pa kohë në Prekaz
Në pamundësi të kthehem mbrapa
Jam vendosur për jetë atje

Arritja në Prishtinë, Tiranë, Paris
E ku tjetër
Është pa mua
I mbetur në Prekaz

Atje vetëm njëherë në jetë arrihet
Pastaj në burgun e përjetshëm të imazheve
Shpërngulesh për të mbetur atje

Atje kam zënë vend
Përtej ëndrrës së tyre
Kam lëshuar spirancat t'u bëj ballë valëve

Në Prekaz valët
Janë shndërruar në jehonë
Dhe lënë jetë brigjeve të fushave
Në këtë kohë time të cilën mezi e ruaj
Nga kafshimet e qenve të çartur
Nuk di prej kujt
Nuk di deri kur

## ATDHEU

Nëse shpërngulesh nga unë
Dhe s'di kujt tjetër mund t'i fal aq kohë,

S’di të arrij më askund
Nëse shpërngulesh nga unë
Asgjë s’do jetë imja
As fryma
Nëse shpërngulesh nga unë
Ruana Zot
Nuk do të kem kujt
T’i them mirëmëngjesi

Prandaj përulem
Si fushë pjellore rrëzë maleve
Të lus të më qëndrosh gatitu
Para syve e zemrës
Ashtu siç je
Me të gjitha plagët
T’i shërojmë bashkë

Pa ty si pa diellin
Akulli zë në pritje zemrën
Se ç’ndodh më tutje me të
Një Zot e di

## DISI NDRYSHE

Rrugëtimi është i njëjtë përskaj lulishtes
Trotuari gjithashtu s’ka lëvizur shëtis
Zbres pa e pyetur lodhjen të takoj njeri
Mbetem veç me vetveten qetas pështpërit

Kam plot përshëndetje të pazbuluara
Të gatshme t’ua fal të njohurve të mi
Si dje edhe sot përqafime të caktuara

Shndërrohem në dëshira të ditës të ngujuara

Disi ndryshe frymojnë rrugët kafenetë
Fytyra të panjohura si në qytet të huaj
Nxitem ta pyes ndokënd për adresën time
S'di nga tretet dhe nuk mundem ta ruaj

Do çaste më duhen që u këndoja kaherë
Pikërisht në këtë shëtitore u kërkoj ndjesë
Kujtimeve të humbura të kohës së shkuar
Që s'më njohin dhe më kot u dërgoj ftesë

Trupo rrugët sheshet dhe trotuaret
E akrepat e orës më përplasen në shikim
Sikur i janë thyer gjymtyrët s'ecin dot
E s'lëviz gjaku në dej, eu – trishtim

Rrugët nuk më njohin e fort mirë i njoh
Guralecët e njëjtë para shqelmit më rrinë
Tek merrem me to nuk di ku gjendem, oh
Në ndonjë botë tjetër – apo në Prishtinë.

**Linditë Ramushi**

Linditë Ramushi u lind më 18.12.1984 në Gjilan ku edhe kreu shkollimin fillor e atë të mesëm.

Studimet universitare i filloi në vitin 2004 në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Fakultetin Filozofik, dega Psikologji dhe i vazhdoi më pas në Universitetin e Prishtinës.
Ka botuar:
"Mos hesht", poezi, SHB Ura, Gjilan, 2004,
"Me sytë e ëndjes", poezi, SHB Beqir Musliu, Gjilan, 2012.
Është pjesë e antologjisë me poezi për nënën "Lotët e virgjër", përzgjedhur nga shkrimtari Fatmir Terziu, Londër , 2012, si dhe e një antologjie tjetër në gjuhën frënge, botuar në Belgjikë nga Vasil Capeqi, më 2012.
Në festivalin e poezisë, "Takimet e Poeteshave Shqiptare 2011", në Vushtrri, shpërblehet me vendin e dytë për poezi.
Autorja është anëtare e asociacionit të shkrimtarëve Ars Clubi "Beqir Musliu", si dhe e redaksisë së revistës letrare – kulturore "Agmia", organ i këtij asociacioni.

## MARR DITËT MBI SUPE

Mbi gjunjë ulur pushon sot duke fshirë djersën
Kur heq nga gjoksi një copë lëkurë
Ta jap ty dhe e mban gjersa freskohem
Ajo copë lëkure është një shtresë e pëlhurës.

Djersa sikur vaj ulliri të pjekur
Gjersa freskohet fryma ime
E njeh dhe dora jote rrëshqitjen e saj
Nëpër shtat kur i kalon drithërima e dashurisë

Dashurisë dhe peshës.

Marr ditët mbi supe
I vesh sikur gjerdan të luluar me fije ari
Nëpër to qëndiset dhe nuri yt i kulluar nga djersët
Djersët ngjajnë në vaj ulliri të njomë atëherë.

Prapë ngrihem e marr dhe atë copë lëkure
Në gjoks humbet heshtja
Ti e mban freskinë time
Dhe peshën e kam më të lehtë.

## STACIONI I FLETËVE TË VJESHTËS

Guralecët e artë shtruar si rrufe nga erërat
Forma e tyre e veshur në mejdan me diellin
Syçelë mbetet agu duke parë vijat e dritës
Rrëke rrëke pikat e djersës venin në stacionin e ndalesës.

Edhe trungjet me dy-tri fleta ngjitur
Njëra bishtzverdhur
Tjetra kokëskuqur
Kokëskuqur si buza e zjarrtë kur pret puthjen e mallit.

Guralecët dhe agu syçelë
Rreshtime të fletës së artë në ndalesën e pritjes
Aritmia e zemrës i thyen shkallët e prekura nga shputat.

Dhe zbret ngadalë
Në stacionin ku priten fletët e vjeshtës
Të artës fytyrë dhe të kuqërremtës ëndërr
Pa peshë të fryrë si pupla të dushkut

## KUR TË BIE HËNA E PLOTË NË SY

E plotë hëna sodit fytyrën tënde
E plotë dhe pamja e saj në hije
Zgjatur imazhin e vërtetë
Se fsheh dot nga dritë e huazuar.

Zvarrë kalon ngjyrë e saj mbi pullaze
Zvarrë kalon dhe në zemër një hije e njomë
Vetëm dashuritë e vërteta vrasin
Vetëm ato si hëna e plotë gufasin gjoksin.

Dritë e bardhë e ditës së nisur
Sot fytyra si hënë e përhime
Sot ajo ngjyrë si lis ahu në mes të pyllit
Sodit nga larg mes qepallash sytë e mallëngjyer.

Fija e hollë lehtë valëzonte nga hukama
E belit kalitur iu bë ajo e mbështjellë si armë
Nën hënën e plotë me dritë
Vetëm vezullima ndrit për të nesërmen ditë.

Trumcak të jesh në dorën time
Ngrohur do të jesh
Kur të bie hëna e plotë në sy.

## KOHA S'NA TAKON NEVE

Zëri po më lëngon në atë vorbull fjalësh
Ngjitur rri portreti mendimtar qëndron heshtur
Mes kornizës së paqepur
Sikur thotë
Koha s'na takon neve.

S'na takon neve koha e thatë
Dhe kur qaj e s'prek fytyrën me hije të verbër
Buzëqeshja për zemrën e përlotur
Bëhet hark vendimtar.

S'na takon kjo kohë e majme
Që kur hap sytë
Ëndërroj të jetë veç makth i natës së shkuar
T'ia shter burimin ku kullon ai vrer si argjend i flakosur
Rremat e fishkura të yjeve që shohin e s'flasin.

E kur mbillet lulja e bardhë në tokë të motit të vjetër
Koha s'na takon neve në lindje të një flete
Veç nuri i ngelet si peshqesh
Peshqesh sërish për pritje.

## MË LËR TË PSHERËTIJ

Jam bërë si frymë
Si grimcë oksigjeni që mban gjallë qelizat
Ta mbaj gjallë dhe vijën e qafës tek lakohet
Ta fashit dhe tymin e zi rreth syve të jeshiltë

Më lër

Ma lër lotin të prek faqen deri te buza
Le të rrjedh sikur rrjedh në fletë vesa e ftohtë
Mos e fshij me dorë
Ma lër të ma çaj dhe lëkurën si valë e ngrohtë
vullkani.

Ma lër të vijëzoj fytyrën një pikë e njelmët
Se ajo shije vjen nga një burim i verbër tymi
Oh ma lër dhe ajrin të më hyjë ne mushkëri
Të më këputen këmbët vrapimit maratonik.

Ma fik dhe fijen e plotë të dritës
Tek po e shtrëngoj në gjoks me grusht
Veç mos më lër si pishë rrëzë malit puthitur
Se ngjyrë e sajë humbet kur i shkulet rrënja.

Më lër të psherëtij dënesjen në shi
Se rruazat e gjakut marrin ngjyrë të ndezur në
diell
Atëherë do të ngjallem dhe njëherë nga ajo
ngjizje

Në mes zjarrit dhe frymës
Sikur lind një dashuri

## BRI I RILINDJES

Le të bëhem bri i dhimbjes tënde të rilindjes
Edhe peshën do ta mbaj në kurrizin me fije të
sheshta

Të të rrjedh gjaku si verë e vluar në zjarr
vullkani
Atë vend do ta njomë hukama e psherëtimës në
zjarr.

Ec po deshe dhe mbi plagën time
S'je më i rëndë se malli i dy stinëve të rrahura
me erën
Gjersa ti ec
Bri i rilindjes tënde jam.

Mund të të tremb tufan i thatë
Të ta marr në gjoks ushtimën e zemrës
Aty ndër tokën e kulluar me ujë ku njomë buzët
Do të jem bri i dhimbjes së rilindjes.

Ti ec…

## MELODIA E KËNGËS TËNDE

Shteg më shteg udhëtoi
Deri në veshin tim
Melodia e këngës tënde të blertë
Për të prekur mëndafshin e flokut
Për të rrëmuar lëkurën prej dëshirës.

Krejt pak shihej fija e flokut mes gishtash
Linja e dritës si ylber mes reve
Shpërtheu një kupëz luleje të bardhë
Ajri puthitej në flegra
Petalet u çelën pak e krah
Diellit i dolën përballë.

E ëmbël
Kjo kupë e qershisë së ndezur
Si valë rridhte nëpër damarë lëngu i saj
Shtati i hedhur
Rrjedhën përcillte plot guxim
Ndezur nga shkëlqimi syve
Zjarri lajmëtar shpërtheu.

Ëndërr e moçme
Pushonte mbi trupin tim
Nën peshën e tij qelizat po ringjalleshin
Flutur në ajër po rrihja krahët mbi shpatulla
U mblodha nën krahë
Si në çerdhe të pranverës së hershme
Buza digjte në qafën e zgjatur prej mjellme
Ngrohin shtatin përkëdheljet e diellit.

Ëndrrës së njomur
Ia ktheu ngjyrat shpirti i blertë
Mirë i krehu edhe plagët e marra betejave të dashurisë

Në heshtje dëgjohej veç zëri i këngës tënde
Edhe i këngës time
Ti po këndoje pa zë
Fashitjet e nënzëshme dolën mbi rërë
E Ari ... në ballë.

## MBI QAFËN TËNDE

Mbi qafën tënde kam rënë
Të prehem në flladin e ajrit pranveror
Brishtësisht nga malli
Mbi qafën tënde shtrihem gjumin të arnoj.

Kam rënë fuqishëm
Të lidh fijet e argjendta
Kujtoj
Kam rënë mbi qafën tënde.

Eshtrat shtrirë mbi shpatullën prush
Ashtu e dehur a magjepsur
Siç del avulli nga verë e vluar
Kam rënë mbi qafën tënde.

S'kam për të vajtur mbi kodrinë
Për të parë lindjen e diellit
Tek pushoj rreth kthjelltësisë sate
Kam shtegtuar cepat e skeletit.

Në qafën tënde
Asht ngjitur s'ngelet veç nga një përqafim

## RRUGA IME E QUMËSHTIT

Sa rrënjë janë zgjatur nga dheu im
Për të të rrethuar
Ty rruga ime e qumështit
Duart na veshin epshin e etur.

Të etur për puthje
Për shtrëngim duarsh zgjatur mbi qafë

Për ngjyrën e zërit që ta njoh
Që buçiti zëshëm
Si hëna e hirtë me ngjyrën e ditës.

Sa e ngrohtë ti rruga ime e qumështit
Shtrati yt i amshimit
Shkronjat që germëzohen me buzën time
Dashuri
Rruga ime e qumështit.

## VJESHTËS SË ARTË

Ky kujtim seç më vjen në mend
më pik rrjedhshëm siç kalon vesa në petale të lules
ma përshkon trupin.

Se kështu erdhe dhe ti atëherë
me gjethe të arta në vjeshtë
unë të prita e buzëqeshur se vjeshta veç emrin kish të tillë
sillej rreth ne të dyve si pelerinë dashurie.

Vjeshtës së artë që sillet dhe sot me nur të kuqërremtë
ia kujtoj fytyrën e njomë të frymës së brishtë.

Dhe ne të dy si vjeshta me ngjyrim të ngrohtë
duket si e përqafojmë natyrën tek ecim në bulevard
ngjyrat e pemëve të gjata tokën
në duart tona njëri-tjetrit pa lëshuar asnjë çast.

**Musa Ramadani**

Musa Ramadani u lind më 1944 në Gjilan.
Musa Ramadani, qysh si foshnje, bashkë me familjen, nga pushteti i atëhershëm, u deportua në Prizren, ku e kreu një pjesë të shkollimit fillor, për ta vazhduar atë (me të kthyer sërish) në Gjilan e në Viti. Në Gjilan e kreu edhe shkollimin e mesëm (Shkolla e Nxënësve në Ekonomi), ndërsa në Prizren – Shkollën e Lartë Pedagogjike, Dega e Letërsisë dhe Gjuhës. Që nga bankat e shkollimit të mesëm zu të merret me gazetari e letërsi, në mënyrë që, që nga viti 1965 e deri në mbyllje të saj pas vitit 2000, të punojë gazetar, redaktor në të përditshmen "Rilindja".

**Krijimtaria letrare-skenike dhe publicistike**

Musa Ramadani është prezantuar në disa nga vëllimet, panoramat letrare e antologjitë, të përkthyera edhe në gjuhë tjera. Është laureat i një sërë çmimesh. Talentin e tij prej krijuesi pluridimensional, e ka sprovuar edhe në krijimtarinë e fushave të tjera artistike. Është autor i një sërë tekstesh për këngë të lehta e të muzikës së tendencave moderne. Është autor

edhe i disa këngëve në frymën e zhanrit të muzikës së lehtë. Ndonëse pa ndonjë përgatitje paraprake muzikore, ka kompozuar këngë të cilat, madje në manifestimin më të madh muzikor të kohës "Akordet e Kosovës", janë vlerësuar edhe me çmimin e parë të jurisë profesionale. Herë pas here, është marrë e merret edhe me pikturë. Madje një "kaptinë" e tërë e romanit të tij të fundit "Inamor: 55", është e "ilustruar" nga vetë punimet e autorit. Ramadani ka shkruar edhe humoreska, skeçe humoristike e shkrime satirike, me pseudonimin "Babloku". Merret edhe me shkrime eseistike e kritikë teatrore, sikundër edhe me udhëshkrime (nga Vjena e Parisi). Drama "Moisiu në unazën e Inflandit", në sezonin 2003, u inskenua nga Teatri Kombëtar i Prishtinës, ndërkaq, drama "Ligatina" e Nebi Islamit, shkruar sipas motiveve të romanit homonim të Musa Ramadanit, në sezonin 2006, u inskenua në Teatrin Kombëtar të Gjilanit. Musa Ramadani punon me një përkushtim të madh, gjithnjë duke i qëndruar besnik frazës e vargut të latuar deri në përpikëri, të një sintakse të kulluar shqipe, të një leksiku të begatshëm shprehjesh është cilësuar nga kritika letrare, siç është vepra "Ligatina", sikundër edhe "Zezona" e një sërë tregimesh të përmbledhjeve të tij. Çmimi "Beqir Musliu" Çmimi letrar "Beqir Musliu" 2006, iu nda Musa Ramadanit, poetit, prozatorit, publicistit, teatrologut të

njohur të letrave shqipe, shpërblimi për vitin 2006.

**Vepra letrare**

"Mëkatet e Adamit" (poezi), Rilindja, 1969;
"Thirravaje" (poezi), Rilindja, 1971;
"Neurosis" (poezi), botim autorial, 1973;
"Romani pa kornizë", Bota e Re, 1975;
"Muzat nuk flenë" (poezi), "Rilindja, 1976;
"Fluroma" (tregime), Rilindja, 1978;
"Zezona" (roman), Rilindja, 1978, Faik Konica (ribotim), 2003;
"Fjala në skenë" (recensione për shfaqje teatrore), Rilindja, 1080;
"Alfabeti i neurozave" (poezi), Flaka e Vëllaznimit, 1983;
"Ligatina" (roman), Rilindja, 1983;
"Moisiu në unazën e Inflandit" (dramë), Rilindja, 1984;
"Eugjenika e tri deteve" (poezi), Rilindja, 1986;
"Satana ma vodhi gurin e urtisë" (tregime), Rilindja, 1987;
"Nostalgji antike" (përzgjedhje e poezive), Rilindja, 1995;
"Vrapuesja e Prizrenit" (roman), Dukagjini, 1997;
"Antiprocesioni" (roman), Buzuku, 1997;
"Inamor: 55" (roman), Buzuku, 2000.
"Mëkatet e Ha(E)vës", poezi, Pen/club, 2007, Prishtinë "Premiera shqiptare" (Recensione për dramën, shfaqjet), Spektri, Shkup 1996;

**Përkthimet:**

"Mariamna" – PärLagerkvist

"Fillokteti" – Heiner Müler
"Askushi" – Jezi Andzejevski
"Shkretëtira e tatarëve" – Dino Buzzati
"Legjenda për Araratin" – Yasar Kemal
"Bufi i verbër" – Sadec Hedayat
"Dhe nuk gjej vëlla më të mirë" – Maksud Ibrahimbekov
"Humbella" – Mirko Kovac
"Ditë pranvere" – Ciril Kosmac
"Aromat, ari e temjani" – Slobodan Novak
"Piramida e Emës" – Dubravka Ugrešić
"Ogursëzi" – Nedzad Ibrisimovic

## KËSHILLA MIKUT TIM

Mik
Shtëpitë tona si gota cakërrohen
Gjerdhe as dyer përmes s'kemi bërë

Dielli
Udhën deri te ne kur e gjen
Gëzim kujt më tepër i bie

Ty apo mua?

Mik
Livadhet tona si dashnorë puthen
Gurë a mezhde askund s'kemi vënë

Shiu
Sixhim teposhtë kur rigon
Në cilin më shumë fryt lëshon:

Në tëndin apo timin?

Atëbotë
Kujtohu mirë lum miku im
Përse prore më bën të druaj?

Se për dallim o dredhim
Koha kaherë ka kaluar

## JO, FAQET E PARA TË GAZETAVE S'I LEXOJ

Brenga mendjen në merimangë ma pështolli
Tmerri zemrën në fole minjsh ma shndërroi

Faqet e para të gazetave
Kurrë më s'i lexoj

E rëndë është ajo peshë fjalësh
Si shi plumbi në shpirt më rigojnë

I kam lutur sytë që fjalën
Luftë të mos e venerojnë

I kam bindur veshët që fjalën
Mortje kurrë të mos e dëgjojnë

E kam urdhëruar gojën që fjalën
Gjak përjetë të mos e shqiptojnë

Se e rëndë është pesha e fjalëve
Si shi plumbi në shpirt më rigojnë

Dëgjomëni ç'ju them
Unë faqet e para të gazetave
Jo, nuk i lexoj kurrë më!

Gjersa njerëzit në bisha shndërruar
Shekullin e zjarrit s'do ta kenë shëruar

## NJERIU KA NJË KOKË NJË JETË NJË DASHURI

Njeriu ka një kokë
Glob i gjallë për lule e predha
Ku drejtpeshohen hapësira e koha

Mos luani me kokën e tij!

Njeriu ka një jetë
Skenë e mirësive ndaj mëkateve
Pse lindin e vdesin çdo ditë

Mos luani me jetën e tij!

Njeriu ka një dashuri
Fjalë (vallë) e tepërt në histori
Nga ligjërojnë mëkatet e motivet
Mos luani kurrë me dashurinë e tij!

## VETËM NËNA VETËM

(Letër Nënë Symbyles që s'do t'i arrijë kurrë)

Jam imunizuar i tëri kundër harresës
Gjurmët e kujtimit s'mund të m'i fshijë kurrë

"Atë ditë që shohim nënën të vdekur, fillon pleqëria"
Aforizmin e një mençuraku veç ma rikujtoi
Vesa e papandehur në globin tim të gjallë

Jeta më mësoi të kuptoj mijëra shikime
E shikimi Yt i mbramë enigmë më mbeti

Nënë

Vetëm në ndarjen memece fare s'kam besuar!

Ato ditë befas sytë e mi shteruan, më fal
Dhembja më ishte peshë më e rëndë se loti

E dije se shkrova vjersha e libra mbi mëkate
Në asnjë varg të lirë s'të zura ngoje dot
Jeta jote jeta ishte vargu më i bukur imi

Në bregun e fashës Ti më s'i ndien këto fjalë
As vajet që tërë jetës sime do të rigojnë

Por... kundër harresës jam imunizuar i tëri

Kurrë s'mund të m'i fshijë gjurmët e kujtimit

## TËHUAJIMI

Mësyva për të satën herë këtë qytet

Pa ëndrralla e gjakime
Sall të shkëmbej ndonjë fjalë me miq
T'ia uroj ndokujt martesën
T'ia përgëzoj familjen ndoshta
Ngushëllime t'i shpreh ndokujt
Po shokët luftonin me brengat dëgjova
Miqtë ishin dalldisur në pontë e poker
Të tjerët me se merreshin as që pyeta
U kujtova: muajt ishin ndërruar në kalendar
Dhe vitet pritnin të shumëzohen ndër vete
Në bujtinë udhëtarësh të rastit ktheva
Duke darkuar me vetveten në qindra pjesë
Njëri plot domethënie më shikoi e shikoi
Si një ardhës që befas sjell fatkeqësi
Tjetri vërente ashtu plot dhembshuri
Se si vetëluftoja pa mëshirë në vetmi
Portierit i kërkova dhomë me një shtrat
Duke thënë: do punoj, pa treguar frikën
Në qytetin e lindjes në qytetin tim
Dyer që hapen oda që grishin s'kish

Atëherë në dhomën (më duket) numër 209
Ndjeva se sa i rëndë qenka tëhuajimi

## MIQTË E MI MEMECË

Ja, ndodhen në dhomën time frymojnë
Të vegjël, të mëdhenj, të hollë, të trashë
Të bardhë, të zinj, të kuq, të verdhë
Dërdëllis me ta netëve si me vetminë
Nuk më hidhërojnë, nuk më kundërshtojnë
Më gjezdisin pa përtesë ndër kohëra e hapësira

Civilizime e rrënime, qytete e shtete më shpien
Dhe prapë më kthejnë këtu në dhomën time
Qëndrojnë heshtazi ndanë murit më vështrojnë
Pranë njëri-tjetrit në këmbë e gjithë huti
Në ballë shkronjat seç ua shndrisin emrat
Zemrat u janë të hapura për shpalim
Çdo gjë shoh e ndiej tek miqtë e mi
Duke udhëtuar në vete pa shpresuar për kthim
Ndonjëherë edhe grindem ashtu fëmijërisht
Në ndërrim motesh me ta të vdekur a të gjallë –
Pse nuk më përgjigjen po veç tok më dëgjojnë
Bah, as miqtë memecë s'janë ngushëllimtarë të mirë!

## MIQTË DHE HIJET E TYRE

Në cilën stinë vallë të marrësh udhë
Çfarë rruge dredhore të ndjekësh
Ku të ndalesh për pushim e një pikë ujë
Cili bisht gjarpri të zvarritet deri në krye
Kur të nisesh me atë të verbëtin besim
Është mirë të ndalet ora në fillim të shtegut
Busullën gjithsesi ta harrosh me qëllim
Natën të ecësh si në lojën symbyllazi
Armën ta varësh në mur për kujtim
Fjalët t'i ruash deri në takim
Heshtjen ta bartësh si mëkatin deri në shpinë
Sytë të mos i ndërsesh si qentë e zgjidhur
Këmbët të mos i urdhërosh si ushtarë të gjorë
Duart t'i shtrish me shuplaka kthyer teposhtë
Kokën ta ngresh lart si krushku në dasmë
E në trastën e zbrazët krahaqafë të marrësh

Një libër të vogël për ta dëftuar kthimin

Se në vend të miqve të ardhshëm e të rinj
Ngjet të të presin vetëm hijet e tyre

## HISTORIA E PIKËS SIME

S'pari unë s'isha veçse një pikë
Më pas u mërzita e u bëra presje
Aventura filloi brenda gjysmëharku
Kaluan shekuj, era e mileniume, epoka
Luftëra, armëpushime, shumë paqe e pak liri
Harku ecte udhës së rrethit e u mbyll
Gjysmëshekulli isha një zero e madhe
Në fillim të këtij mileniumi të tretë
Druaj në mos do të kthehem sërish në një pikë
(Më 30.08.1993)

## AS I MBYS TË DASHURIT E MI AS I NGJALL

Njeriu e koha shpalojnë misteret
Mistike mbetet vetëm vdekja mistike

Ç'të bëj me një jetë e njëmijë vdekje
S'mund t'ju ngjall nga mjegulla
Pas katërmijë e pesëqind vjetësh
Si Gilgameshi i lashtë e mitik
Mund të provoj e të gjej ndonjë barishte
Kundër pavdekësisë ose amshimit
Por druaj nëse në udhëkryqet e botës

Do të has papritmas ndonjë pasardhëse
Të nimfave sikundër ajo Sabita e urtë
Që të vërtetojë kotësinë e gjurmimit

Nuk dua t'i ngjall përsëri nuk dua
As t'i mbys nuk dua dot t'i mbys
Të dashurit e botës nga mjegulla

Misteret i shpalojnë njeriu e koha
Vetëm vdekja mbetet mistike vdekja

Vetëm vdekja nuk gënjen në botë
Ligjëron nga përvoja Sadek Hedajati
(26.09.1979)

## POETIT TË AMSHIMIT
(Mikut Beqir Musliut)

Kurdo që rrinim unë e ti, donim dhe të heshtnim
Nëse fjalët humbnin kuptimet, heshtja ua kthente

Më 24 qershor se si më humbe krejt papandehurazi
Në mos je fshehur diku siç e kishe shprehi dikur
Dhe do të gjendemi befasisht nëpër muzikën e sferave

Unë s'e mohoj vdekjen veçse edhe ringjalljes i besoj

Më humbe enkas hapësirave mistike e shumëpërmasore
Por edhe përtej "Librit të anatemave" do të të kërkoj

Ti do të më shfaqesh si një surprizë në pa(n)kohësi
Që sërishmi ta vazhdojmë në duet atë farë heshturime
(Ulqin, 27 qershor, 1996)

**Ramadan Mehmeti**

Ramadan Mehmeti, që prej botimit të veprës së parë, me poezi për të rritur, "Jeta pa titull", 1977, nuk u ndal së shkruari. Që nga kjo kohë, letërsia për të u bë pjesë e jetës, vetë kuptimi i saj. Me këmbënguljen, durimin, zellin dhe prirjen, që rregullisht e ushqeu me gjetje të reja artistike, letërsisë shqiptare i dhuroi mbi 25 vepra zhanresh të ndryshme. Ramadan Mehmeti u lind më 20 shtator 1948 në Livoç të Ulët të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë. Studioi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Me shkrime letrare merret që nga bankat e shkollës fillore. Është bashkëpunëtor i të gjitha gazetave dhe

revistave në gjuhën shqipe. Shkrimet e tij janë përkthyer edhe në gjuhët rumune, serbe dhe boshnjake dhe është nderuar me shumë çmime letrare. Është i përfshirë në disa antologji, si në Kosovë, Shqipëri dhe në Rumani. Është editor i shtëpisë botuese "Rozafa" të Prishtinës. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Është anëtar i Karvanit të Shkrimtarëve të Kosovës. Jeton dhe vepron në Prishtinë.

**Vepra të botuara**

**Poezi për të rritur:**

1. "Jeta pa titull", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1977
2. "Koncerti i heshtjes", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1987
3. "Loja e ruletit", poezi, Plejada, Prishtinë, 1994
4. "Requiem për Mirko Gashin", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1997
5. "Ringjallja", SHSHK, Prishtinë, 1998
6. "Brigje shpirti", poezi, Rozafa, Prishtinë, 2004
7. "Mëkate të zgjuara", Rozafa, Prishtinë, 2004
8. "Loja e ruletit", botimi i dytë, poezi, Faik Konica, Prishtinë, 2006
9. "Harpa e zemrës", poezi për të rritur, SHB Beqir Musliu, Gjilan, 2011

**Poezi për fëmijë**

10. "Ti je e vogël", poezi për fëmijë, Iliriku, Prishtinë, 1997
11. "Te guri i atdheut", poezi për fëmijë, Prishtinë, 2000
12. "Zemrat bëhen ura", vjersha për fëmijë, Rozafa, Prishtinë, 2002

13. “Testament i gjyshit”, poezi për fëmijë, Prishtinë, 2006
14. “Te guri i atdheut”, botim i dytë, poezi për fëmijë, Prishtinë, 2006
15. “Kur pikëllohen zogjtë”, poezi për fëmijë, Rozafa, Prishtinë, 2007
16. “Të kam zog”, poezi për fëmijë, Rozafa, Prishtinë, 2010
17. “Bora me akullore”, poezi për fëmijë, Rozafa, Prishtinë, 2012
18. “Sheshi i shqiponjës”, tregime për fëmijë, Faik Konica, Prishtinë 2012

**Drama:**

19. “Ura e Maskatarit”, dramë, Rozafa, Prishtinë, 2007
20. “Poshtërim i ndjenjës”, dramë, Ombra GVG, Tiranë, 2007

**Përzgjedhje:**

21. “Bekim i gjurmëve”, libër i poezisë së përzgjedhur nga Anton N. Berisha, Rozafa, Prishtinë, 2008
22. “Testament letrar”, mendimi kritik për krijimtarinë letrare të Ramadan Mehmetit, përgatitur nga Prend Buzhala, Rozafa, Prishtinë, 2008

**Prozë:**

23. “Fusha e korbave”, tregime, Rilindja, Prishtinë, 2000
24. “Hëna mbi taverne”, Ombra GVG, Tiranë, 2012

**Vepra të përkthyera:**

25. “Pentagrama inimii” (Pentagrami i zemrës), Bukuresht, 2009

## EMRI YNË

Një lojë zgjohet në mua përsëri
Gjurmon këngën e lashtësisë
Ëndërron ta hedhë një hap matanë vetes
Derisa të më këndojë rruga nga kaloj
Për një dashuri që më kthen në lojë
E Ti ia mbledh më kot gjurmët ditës
Që na e kanë mbyllur në një rreth të zi
Tash s’mund të dalësh matanë vetes
Edhe pse duart i ke shtrirë në largësi
Gjersa të madhërohet emri ynë i vogël

## ECJA

Ecim
Dhe e vëmë veten në lojë
Pse s'mund t'i zëmë
Kuajt e zinj në lëmë

E gruri u shi në lëmë
E ty të ranë dhëmbët
E mua më kafshoi pezmi i ditës
Vallë, ku mbetën kuajt e zinj
Ecëm
Sa larg na la loja
Zogjtë i ndërruan fluturimet
Akrepat e orës e dremitin
Gjumin e historisë së fjetur
Dita më ngarkohet në shpinë
Ty të bien prapë dhëmbët

Sa na afroi loja
E ne prapë nuk shihemi

## RRËFIMI I

Unë dhe djalli u takuam diku
Ç'takim i rrallë

Qielli ishte aq lart
Toka aq poshtë
Ç'vrapim kozmik

Shpikëm një djallëzi
Për të mashtruar Perëndinë
Që të mos lindte njeriu
Sall lojë e tij e verdhë

Perëndia megjithatë
Sillet në një rreth të zi
Ç'vrapim kozmik

## HARPA E RREME

Derisa thuret melodia
Në harpën e rreme
Në mua prehet kufoma e këngës
A nuk po m'i shihni gishtërinjtë e përgjakur

A s'po e sheh
Gjërat që s'dihen, dihen
Loja vazhdon me të vjetrën

Unë bëj një hap para
Ti më pret në trap
Të më kthesh
Atje ku nuk më ke gjetur
Paraloja e prapa

Lashtësia pikon gjak
Vritet kënga në mur
E po ç'u bë lahuta

Jeta daulle e përbuzur
A nuk të dëftova
Im vëlla Gjergj Elez Ali

## BAJLOZI MATANË DETIT

A po sheh
Nëna shtron përsëri sofrën
Të hetova në hije Bajlozi
Shtroje kokën tonë për darkë

A s'po beson
Gjërat fshihen pas syve të lëbyrur

Sinori e zuri natën në tradhti
Fjala lehonë i mbeti ditës

Në tryezën e Bajlozit
Ta pashë vetëm skeletin

Pas kalit të Rexhës
Balada e vazhdoi

Atë pjesë të jetës
Që i mbeti legjendë

Rexhë – ore
Ç'u bë me Bajlozin

## VARIANT LOJE

Kërkoj prejardhjen time të lashtë
Ma tregojnë majmunin
Ç'ngjasim i marrë

Zogu në fluturim
Ma peshon pikëllimin
Me plagën e Gjergj Elez Alisë

Gjeli historinë
Ma han kokërr më kokërr
Ç'ngjasim me paraardhësit e mi

Macja në sofër grimcon

Qeni i lidhur në stelë
Leh ecjen time të mundimshme
Shikohet me mua në pasqyrë të pusit

Ujku hëngër qengjin
Pse ujin ia turbulloi

Gomari i gjorë
Ngordhi në hijen e vet
Nga mërzia

Njeriu u shikua në mua
I pëlqeu ai vend
U bë gur

Ç'ngjasim thu

## E KËRKOJNË RRUGËN QË S'E GJEJMË

Në melodinë e harpës netët pa gjumë
E kërkojnë rrugën që nuk e gjejmë
As në orët e mesnatës së lodhur
E ditën e mbartim të rëndë plumb në shpinë
Matim kohën me pëllëmbë duke ecur
Për të na bashkuar në kor harresa
Etja e ndezur bri vatrës na mban
Të zjarrtë për të na bashkuar fjala e lidhur nyjë
Për atë që nuk u kthye një ditë më parë
Do ta ëndërrojmë hap më hap
Atë rrugë që u ngatërrua deri te Ti
E koha të rrëshqasë në trajtën e zezë
Derisa bota të ndërrojë pasqyrën e vet
Në një legjendë të gjallë të Sheherzades
Matet e mjera kohë që po vdes

## JETËT QË S'I PATËM

Nën Urën e Maskatarit
Ushtojnë flugat
Natën e ditën na ruan qeni i zi
Të na zë në pahir
Ruana Zot prej tij

Na hyjnë deri në gjumë
Pas natës së njëmijenjëtë të numërimit
Tempulli i zi i harrimit
Zhamelat rrotullohen nëpër shpinat tona
Gjurmojnë ruletin e vet
Flugat na përkujtojnë
Jetët që s'i patëm
Por që na i ngatërruan thurimën
Të jetës që e patëm
Veç një metaforë mistike
Udhëtojmë udhëtojmë udhëtojmë
Nën Urën e Maskatarit
Vallë
A do t'i mbërrijnë atë që na mbërrin
Te
Ura e Maskatarit

## KOSOVË I THONË GJILAN

Kosovë i thonë Gjilan
Atë ditë që ndodhi krimi
Biografinë time e lexove
Nën Urën e Maskatarit
Xhamia e Madhe
E hëngri xhematin e vet
Te
Ura e Maskatarit
Rrugët u bashkuan në një
Pa t'i thyer eshtrat
Atyre që i hëngri ai mëngjes i zi
Në masakrën e paparë
Atë ditë të zisë

Në qytetin e mërive
Në Gjilan
E në Fushë-Korb
Kali i shfrenuar nget e s'ndalet
Për ta zënë hapin e vet
Derisa e vrau vetmia
Në mesditë
Në mesditë
Ndodhi krimi në Gjilan
Dobrusha s'fle
S'e lënë klithmat e atyre që i bartte
Nën Urën e Maskatarit

## MBRËMJE LETRARE ME MIRKO GASHIN

(Arbor vitae 1)
«Bredhi nëpër bukuritë që i zbulove ti»

Mbrëmja letrare me Mirko Gashin
Filloi në muzgun e parë të ditës së parë
Që e kishte zënë ai në një fletë
Ku kishte shkruar vargun e fundit
Që Arbor Vitae e zëvendësoi me një lule
Sikur deshi t'i sfidonte vetë poetit
Për t'ia zvetënuar hijen Mollës së Hallës
Që e kërkonte te një varrezë e zbrazët
Për ta ringjallur prapë atë
Të hynte në Mbrëmjen Letrare në paramuzgun
Që vetë e kishte hetuar kahmot
Aty erdhi vetë Mirko Gashi dhe tha
«Bredhi nëpër bukuritë që i zbulove ti»
Nën hijen e Mollës së Hallës mbeti një lule

Në vend të Epitafit që unë (s)ta shkrova
Një minutë pa vdekur Ai që kurrë nuk vdes



Sabit RRUSTEMI

Sabit Rrustemi është i lindur më 3 prill 1959 në Terziaj, fshat në afërsi të Zhegrës, Komuna e Gjilanit. Shkollimin fillor e kryen në Zhegër, atë të mesëm në Gjilan, ndërsa studimet në Degën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe, në Prishtinë.

Në vitin 1977 boton poezinë e parë në revistën "Zëri i rinisë" të Prishtinës. Në vitin 1981, burgoset për shkak të botimit të tregimit "Nën maskën e mysafirëve", në revistën "Fjala" më 1 prill të atij viti, ditën kur demonstratat shqiptare për Kosovën Republikë e mbushën Prishtinën. Dënohet me katër vjet burg nga regjimi i Jugosllavisë titiste, me ç'rast i ndalohet edhe botimi i krijimtarisë letrare. Tek në vitin 1990 boton përmbledhjen e parë të poezive (Ku i la lisat era).

**Veprimtaritë publike**

Sabit Rrustemi përpos krijimeve letrare e publicistike, merret edhe me veprimtari publike. Nga viti 1990 e këndej, ka ushtruar një

sërë funksionesh nga niveli lokal deri tek ai qendror në kuadër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryesisht nga fusha e marrëdhënieve me publikun dhe demokratizimit. Në vitet 2001 - 2004 ishte deputet në Kuvendin e Kosovës.
Gjatë vitit 2003 ka kryer Shkollën Politike të Prishtinës dhe është certifikuar nga Këshilli i Evropës në Strasburg.
Gjatë vitit 2009, ka kryer dhe Shkollën për Integrime Evropiane në Prishtinë.
Aktualisht drejton Ars Klubin "Beqir Musliu", një asociacion alternativ i shkrimtarëve në Kosovë, me seli në Gjilan si dhe revistën letrare – kulturore "Agmia"
Është i martuar, baba i pesë fëmijëve.
Jeton në Zhegër.

**Veprat e botuara:**

"Ku i la lisat era" (poezi), Redaksia e botimeve, Rilindja, Prishtinë, 1990 (libër ky i dorëzuar që në vitin 1981, redaktuar nga poeti i mirënjohur Ali Podrimja).
"Besoj në një diell", (poezi), revista për kulturë, art dhe letërsi, Fjala, Prishtinë.
"Pika e zezë", përmbledhje tregimesh, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1993.
"Jetëshkrimi i Sylë Kopernicës", prozë dokumentare, Shtëpia Botuese Plejada, Prishtinë, 1994.
"Natyrë me vaj", album poetik, Shtëpia Botuese Plejada, Prishtinë, me parathënie të Beqir Musliut.

"Maska e mysafirëve", (tregime) Shtëpia Botuese Buzuku, Prishtinë, 1997.
"Variacione për lirinë" (poezi) Redaksia e botimeve, Rilindja, Prishtinë, 1997.
"Ëndrra që puthet" (poezi), Shtëpia Botuese, Rozafa, Prishtinë 2001.
"Paqja e brishtë" (poezi), Shtëpia Botuese Rozafa, Prishtinë, 2007
"Shiu i buzëve tua", poezi, Shtëpia Botuese Rozafa, Prishtinë, 2009
"Antingere Divina" (Prekje hyjnore), përkthyer në gjuhën rumune nga Baki Ymeri, Bukuresht, 2009
"Nën qerpikun tënd", poezi, Shtëpia Botuese, T-KOM, Shkup, 2009
"Zjarrmi e kthjelltë", poezi, Shtëpia Botuese Beqir Musliu, Gjilan, 2012

**I prezantuar:**

Në vëllimin me tregime nga Kosova, "Djepi i lashtë", Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1982
Në "Antologji e poezisë moderne shqipe", përzgjedhur nga Ferdinan Laholli, Gjermani, 2003
Në antologjinë poetike për Kosovën, "Një gur i çarë", nga Ali Podrimja, 2005
Në Antologjinë poetike "Templul Cuvantului" **(**Tempulli i Fjalës), Bukuresht 2009
Në Antologjinë e poezisë kontemporane rumuno-shqiptare, "Punti De Cuvinte" (Urat e fjalëve), IASI , Bukuresht, 2009

Në Antologjinë poetike, "Muza e mëmëdheut", nga prof dr. Agim Vinca, Shtëpia Botuese Eugen (Tiranë) dhe Artini (Prishtinë), 2012
...
Gjatë veprimtarisë së tij letrare 35-vjeçare, Sabit Rrustemi është fitues i dhjetëra konkurseve letrare në Kosovë, si dhe i orëve të shumta letrare, të organizuara nëpër qytete të ndryshme të trevave shqiptare. Po, është nderuar edhe me mirënjohje të shumta ku, veçohen mirënjohjet, me medalje të bronztë dhe dy herë me medalje të argjendtë, nga Akademia Evropiane e Arteve në Bruksel, në vitet, 2007, 2008 dhe 2010.

## LEGJENDË E HESHTUR

Një legjendë e fshehur
E harruar është Çepuri

Mes dy lumenjsh njomë buzët
Lanë faqet
E trupin me një rigë shi

Flokët i kreh e shkreh
Për dritë hëne

Rrobat i thahen
Me një paradite dielli
Vetëm hijes ngrin dimrit

Nuk ofshan as lëshon gjëmë

Kur ngushtë e nxënë

Përmes gjethesh shushurin
Qanë e këndon si shpend mali
Kur e shkund jugu

Ushton prej malli
Për atë Zanë fushe
Që s'iu bë Orë mali.
(28.08.2009)

## PIKOI
(variant)

Një diell pogaçeje
Me mbrëmjen pikoi
Në këtë fushë të kaltër e pambarim

S'di ishte faqja jote e zjarrtë
Apo ai lot zemre më kërkoi

Tërë natën prita e prita
Deri te kjo Ditë e re

Ajo fushë e kaltër
Vezulloi lart
Universit
Skaj më skaj
Përmes dritës sate

E si mos të kthehem kah Ti
Dashuri

Gjirin tënd kërkoj përsëri

(28.09.2009)

## PRISTE SI NJË ËNDËRR

Ajo priste si një ëndërr
Skaj bebëzave të mia

E kapa për dore
Të tërën
Me krejt shpirtin tim
Në dhomën më të ngrohtë
Të qenies sime
E vendosa përjetësisht

Të plotë
Si hënën në të pesëmbëdhjetë
Me atë fytyrë që shndrit
E rri e çelur
Në sytë e mi

Aromën e saj
Edhe tash e thith
Me afshin e zemrës e shijoj

Të lumin çast uroj
Që e gjeta

Këtu e kam

Pulson pa reshtur
Ora ime e dashurisë

(09.12.2009)

## RECETË E PËRDITSHME

Me lotin e ftohtë të pritjes
Laji faqet
Sytë
E vish rrobat e shpirtit

Shëtitjen e mëngjesit
Bëje nëpër hartën e dashurisë

Nëpër secilën gjymtyrë

Kur të merr etja
Për freski mali
Kthe kah buzët e mia

Po pate kokëdhembje
Ftoje pëllëmbën përkëdhelëse
Që me prekje shëron

Mungesash mos u streho
Aty ku nuk jam
Mos më kërko

Hapit tim
Fjalës që hap atë portë zemre
I beso

*(1 mars, 2010)*

## (V)ETJA IME

Shtere atë heshtje
Atë vapë që vyshk
Atë akull që mërdhin

Pije me fund
E mos u kënaq nga d(j)ergj(i)a ime
Në pritje

Hape atë gojë
Të eturat buzë
Që po shkrumbohen rrëzë teje

Larg ajo hije
Ajo vetull jotja
Ajo palë bleroshe e flokut tënd
Që flladit

Më larg se shikimi im
Më e thellë se heshtja jote
Që vret

Më e zjarrtë
Se vapa që nuk pëlcet

Vetja ime
Po shumë më paske braktisur
(Gjilan, 17 qershor, 2010)

# PËRTEJ NJË VETËTIME

Shiu vërshoi
Nëpër këpucët e mia të zeza

Çorapet e qullura
Më gostitën
Me ngjyra të mbyllura
Pjesëve të sipërme
Të këmbëve
Thembrave

E unë trupoja rrugën
Para makinave
Semaforëve të heshtur
Të lagur
Zebrave të fshira
Të harruara
Se Ti
Më prisje diku
Përtej një vetëtime
Syve përmallim

Këpucët po thahen
Në ballkon
Dhe ngjyra e fituar gratis
U shlye tashmë

Mbete vetëm Ti
Qiell i kaltër dashurie

# Ç'MUND TË TË OFROJ MË SHUMË

Zoti nuk thotë
Harroje
As Zemra

Një det ndjenjash
Qepet Çepurit
Po rruga përpjetë
Deri në kodër

Shtigjet zigzage
I ka mbuluar dushku
Bari i ri
E paecura ime
Vonohet për pak

Ty të ruaj
Thellë në veten time
Edhe kur më ikën me mëngjes
Edhe kur më kthehesh
Rrallë e përmallë
Përmes ndonjë ëndrre

E dashur
Po e deshe malin
Qe ku jam
Po e lype detin
Qe ku e ke
Në shpirtin tim

Dhe mua të tërin

Thellësive tua
Të paprekura

Ç'mund të të ofroj më shumë
Pos shpirtin tim
Të rinuar prej dashurie

(3 korrik, 2010)

## MUND TË BËJË Ç'TË DOJË

Ajo mund të vijë me ditën
Mund të fshihet me natën
Mund të mos bëjë zë
Me ditë e net

Mund të mbyllet si lulja
Nën petale të blerta
Me muaj me vjet

O
Ajo mund të sillet si të dojë
Dhe pa mua mund të jetojë

Unë do ta ndjej
Orë e çast
Në secilën sekondë
Orëzemra do ta kujtojë

Si tash

(17 shtator, 2010)

## NDIZE SONTE

Çepuri flet përmes pamjes
Me fytyrë malli

Rri dhe sonte
Ta përzëmë këtë erë
Këto re përmbi
Që ikin tutje
Pa një pikë shi

Për muza s'do të kesh uri
Të ruaj nga cilado furi
Vetëm rri

Ta ndezim këtë natë
Asaj vashe pas kodre
Që ka humbur udhë
Dritë t'i bëjmë

Të tharat gjethe
Këta rremba të tharë
Të qofshin falë
Sall ndize sonte
Ndize
Për atë hënëvashë
Çepuri nuk refuzohet

## TEK RRËNJA JOTE

Për dallim nga krimbi,

Dyshimi nuk e gërryen
Atë zemër molle
Po loçkën e zemrës

Mos i jep rast
Të të futet në brendi
Trupit jeshil
Qerpikëve të zinj

Strehë e tij
Mos u bëj
Moj perri

Se ajo zemërmollë
Do të gërryhet
Do të bëhet zi

Ajo loçkë zemre
Do të rrudhet
Do të tkurret
E do të varet syve të mi
Plot mërzi

As dyshimit
As krimbit
Strehë
Nuk do t'i bëhesh ti

Verë e dimër
Tek rrënja jote do të rri
Plagët të t'i mbyll me dashuri
Nëpër sythat me lule

Të buloj përsëri
Me fryt të ri
(Gjilan, 6 nëntor, 2010)

**Sevdije Rexhepi**

Sevdije Rexhepi është lindur dhe rritur në Gjilan të Kosovës. Shkollimin fillor dhe atë të mesëm i mbaroi në qytetin e lindjes, kurse studimet për Gjuhë dhe Letërsi Frënge i kreu në Fakultetin Filologjik në Universitetin e Prishtinës. Për dy vite (1996 – 1998), ka punuar si mësimdhënëse e gjuhës frënge në Shkollën e Mesme "Zenel Hajdini" në Gjilan. Nga gushti i vitit 1999 deri më 2006 ka punuar në "Brown & Root Services", në Kampin Amerikan "Monteith" në qytetin e saj të lindjes, ndërsa nga nëntori i vitit 2006 deri në prill 2011 ka punuar në misionin tjetër në Irak me kompaninë amerikane (KBR). Sevdije Rexhepi, përveç gjuhës shqipe zotëron mirë edhe anglishten e frëngjishten, kurse poezi shkruan në gjuhën amtare dhe në anglisht. Punon dhe jeton në Prishtinë. Është prezantuar në këto antologji:

1. "Mozaikë të një portreti", Tiranë, 2004.

2. “Gjuha e dashurisë poetike”, Tiranë, 2006.
3. “Nënës”, Tiranë 2007
4. “Ama e Dheut” 2012, Gjilan

**Veprat letrare:**

1. “Simfoni e heshtur”, poezi, Gjilan, 2003.
2. “Orët e mungesës”, poezi, Gjilan, 2004.
3. “The Sounds of Waterfalls” (Tinguj ujëvarash), poezi, Gjilan, 2004.
4. “Baladë mbi Baladë”, poezi, Prishtinë 2010.
5. „Between Rivers of Babylon”(Mes lumenjve të Babilonisë), poezi, Prishtinë 2010.

## NË KËRKIM TË PROMETEUT

Në një botë pa emër
Ndërtoj muret e Trojës
Me lutjet pafund
Të mos depërtojë
Kjo uturimë qiellore
Që të çon peshë
Dhe nuk e lë rehat
Vallen e yjeve këtë natë

E shurdhër bëhem
Dhe roje e bindshme
Zgjuar...
Në kërkim të Prometeut
Të shndris errësirën
Hëna edhe ajo zgjuar, e ngratë
Të dyja të frikësuara deri në asht
Nga Kali i Drunjtë

U ngjita në Olimpin
E mendimeve të mia
Përsëri u luta në heshtje...
Zeusi – zot i zotave
Më fali ninullën – uratë
Mua dhe asaj

## EMERA

Në lindje u errësua
Perëndimi përqafon të renë
Nga qielli
Emera do të zbres ngadalë
Në dritaren tënde
Fije rrezesh
Do të përkëdhelin fytyrën
Të të thonë se...
Ditë e re po lind
Ti do të zgjohesh
Nga prekje të lehta fluture
Kur të mbërthehesh
Nga ujëvarë mëngjesi
A do të qeshesh
Nga ëndërr e boshatisur?

## METAMORFOZË

Mes roje tempujsh
Ndiej tek frymojnë perënditë
E shkuara më ngre për flokë
Hijet e së tashmes më ndjekin
Si Perseu

Do vjedh syrin nga Graitë
Për të më treguar
Të vërtetën e fshehur
Në copëza letrash
Ngjall kujtimet
Në miliarda pjesë të shpërbëra
E lodhur...
Kthehem te të gjallët
Lë vdekjen fillikat
Supet nuk durojnë më
Kacafytje kohësh

## SHPRESËJETA

Kalova...
Nëpër Via Egnatia
Lexova lavdinë
E lindje–perëndimit dikur
Veriu e jugu
Me bisht të syrit më përcjellin
Pa dashje...
Provokatore për dreq u bëra
Dëshmitare në grindje akrepash
Dhe orë që njëra–tjetrën gëlltisin
Në sfond dëgjoj zëra poliglotësh
Që ditës i ngecin në orbitë
Nëpër rrugë shkronjash
Ecje e lehtë të mos thyhen ato
Mbështjellë me petkun e shpresëjetës

## NË MBRETËRI DRIADASH

Me Ty jam sirenë
Notoj e palodhur nëpër legjenda
Shpirtkështjellën ngritëm nën dete
Njelmësinë ëmbël e zhduk era
Fluturimthi në dendësi pyjesh
Driadat thërrasin në valle
Mysafirë jemi në mbretërinë e tyre
Nën shushurimë gjethesh
Dirigjent... qetësia e kësaj nate
Orkestër... zemrat që rrinë zgjuar
Lidhim bashkë shkronjat
Që për ne shndrisin
Qielli lexohet pa fjalë
Çasteve kur Hypnosi
Ka harruar të na marrë

## TË TASHMEN PREK

Në pamjen pa fjalë shikimi flet vetë
Pafundësia hap gojën të të përpij
Shfaqje e zymtë shkronjash
Që nuk lindin dot fjalët
Kur në vallen e tyre pa ritëm
Lozet me hapa të dehur
Ndër shtrëngata të çoroditura
Zgjohem në një botë tjetër
Të tashmen e prek nga afër
Jetoj me shekujt që ikën
E përgjumur...
Mbulohem me jorgan lashtësie
Shtrij këmbët në Babiloni
Se ëndrrat m'i përkund Iliria

## NË BABILONI

Gjea... u rizgjua nga Kaosi
Qindra shekuj
E rëndojnë mbi supe
Në një cep
Damarët e shterur nga thatësia
Hermesi pa mëshirë
Ditët ia lidh me zinxhirë
Heliosi i pjek në rërën zbrazëtirë
Mijëra thërrmija pafundësisht
I merr era
Nga lufta qiellore
Për pak çaste
Pikëza që bien vertikalisht
Zeusi dhuroi freski
Në një skaj të botës
Diku në Babiloni

## SOMNAMBUL

Rrëshqas shkretëtirës
Rëra përcëlluese më djeg lëkurën
Zhytur...
Gjurmëve të vjetra
Ku dikur Lindje e Perëndim
Kryqëzoheshin në Bagdad
Nuk e shikoj dot Heliosin
Se më verbon dritën në sy
Somnambul shoh Perlat...
Aty ku së pari u gjet koha e humbur

Ngjitem qiellit si feniks
Kur digjej e shkatërrohej nëpër histori
U lodha duke bredhur
Civilizimeve të lashta
Sumeriane
Babilonase
Asiriane
Hapa sytë, për çudi
Frymova lirisht vetëm
... në Iliri

## NGA MBRETËRESHA NË FRON

E patrembur nga e nesërmja
Pushoj në Panteon
Kur ditës i zihet fryma dhe mua
Me eter sytë fërkoj
Nëpër epe e mite duke bredhur
Alivanosur dhe ringjallur
Lot i dhembjes në tigër derdhur
Shpirti shëtit karvanëve në shkretëtirë
Ndër tempuj e trungje palmash
Në kërkim të sekretit të lavdisë dikur...
Dërguar nga Mbretëresha në Fron
Shqiponja fluturimthi më vjen në Mesopotami
Aortë e saj më mban ende të gjallë
Sot e shumë shekuj më parë
Më mbron me krahët e saj

## ME FLOTË LIBURNE

Përtej vetëhijes

Mas kohën në lashtësi
Valë jete thyej me flotë Liburne
Kryq e tërthor i bie historisë
Në qiellin e pafund të Babilonisë
Gdhendur shqiponjë e gjallë
Më jep fuqi në ditët e stërzgjatura
Krahët e saj m'i falë
Të fluturoj etshëm në Dardani
Sa herë damarët më shteren
E sytë verbohen nga kjo thatësi
Oh, sa herë kthehem atje
E vij këtu përsëri

**Xhevat Latifi**

Xhevat Latifi është lindur dhe rritur në Gjilan, Kosovë. Ai mban ndiplomë universitare në arsim nga Fakulteti i Edukimit, Universiteti i Prishtinës dhe aktualisht është duke ndjekur masterin në Sociologji në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Maqedoni. Z. Latifi është anëtar i Shoqërisë së Shkrimtarëve të Kosovës dhe deri më tani ka botuar dy libra me poezi: "Vdekja Kushton Shtrenjtë/Vdekja është e shtrenjtë" (1997) dhe "Shi në Flokun Tendencë/Shi mbi flokët tuaj" (2005). Ai ka përvojë të gjatë në gazetari dhe ka punuar për

RTV 21, Gazeta “Lajm”, “Express”, TV “VALI” dhe aktualisht është korrespondent i RTK-së, transmetues kombëtar publik, duke mbuluar rajonin e Gjilanit. Z. Latifi është i martuar dhe ka tre fëmijë. Poezitë e poetit Xhevat Latifi, janë të botuara edhe në vëllime të përbashkëta të poetëve dhe nëpër revista të ndryshme letrare si “Haemus” Bukuresht, ”Sheshi” Prishtinë, “Drita” Tiranë, “Jeta e Re” Prishtinë, "Gazeta e Athinës", “Koha Ditore”, “Agmia”, e revista të tjera të Kosovës, Shqipërisë dhe të gazetave në gjuhën shqipe në Maqedoni. Nga viti 1999 është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Ka marrë shpërblime të ndryshme të konkurseve letrare dhe ishte pjesëmarrës i takimeve të poetëve shqiptarë në Shkup, 1999 dhe në Festivalin ndërkombëtar të poezisë “Vjeshta 2003” në Pogradec. Poezitë e Latifit, janë përkthyer dhe janë botuar gjithashtu edhe në gjuhën rumune në revistën “Haemus” ndërkohë që janë botuar edhe në Antologjinë e poezisë Shqipe në Shqipëri sikur dhe në antologjinë “Lotët e virgjër”, përgatitur nga Agim Mato e Fatmir Terziu, botoi SHB “ACPE&LULU“ – USA , 2012. Poezitë e Xhevat Latifit janë përfshirë edhe në Antologjinë në gjuhën angleze, një përmbledhje e 30 shkrimtarëve nga e gjithë bota, "Emanations"- të botuar nga International Authors 2012 , me redaktor Carter Kaplan. Xhevat Latifi, gjithashtu ka marrë pjesë edhe në ekspozitën e përbashkët me asociacionin e artistëve

alternativ “Varg e Vi” Gjilan 2010, dhe performancën artistike “Ma thuaj një fjalë të mirë”, Prishtinë 2012. Me poezitë e tij të përkthyera në gjuhën angleze, gjermane dhe frënge ai u prezantua edhe në ekspozitën në Ambasadën e Shqipërisë në Bernë, në kuadër të shënimit të 100-vjetori të shtetit shqiptar. Xhevat Latifi është fitues i disa konkurseve letrare:

Në janar 2011 në orën letrare “Pena e Flakës”, në kuadër të manifestimit "Flaka e janarit” mori shpërblimin për poezinë më të mirë të lexuar “Dimri ballkanik ose patinazhi i vjedhjes”.

- Çmimi Krijuesi i vitit, Gjilan 1997
- Çmimi Poezia më e mirë – “Flaka e Janarit, Gjilan 2005”
- Çmimi Poezia më e Mirë “Albuniversi”, Stubëll 2007
- Çmimi Poezia më e Mirë “Flakadani i Karadakut”, viti 2009
- Çmimi Poezia më e Mirë “Muza e Agimit-Ditët e Heroit Agim Ramadani”, Zhegër 2010
- Çmimi Pena e Flakës” – “Flaka e Janarit, Gjilan,2011”

Poeti, sociologu dhe gazetari Xhevat Latifi jeton dhe vepron në Gjilan. Është i martuar me pedagogen Lumnije Korça dhe kanë dy vajza Lemba dhe Valma dhe djalin Bliri.

## MA THUAJ NJË FJALË TË MIRË

Ma thuaj një fjalë të mirë

Të shoh qiellin në sy liqeni
Ta ndjej aromën e bukës në çerep
Te pleqëruar në odë
Ta hap një portë dheu
Më thuaj një fjalë të mirë
Se Thalia* ka intrigën aritmi moderne
Si sot, si dje ...
Qe dymijë vjet fjala e mirë nuk plaket
As gjumi nuk e zë
Një fjalë vdekjen e tremb!
**Thalia*- muza e Dramës…**

## HELVETIA OSE TREGIMI PËR TY

Ky liqe si lot mjellme më kujton jugun
Melodi takesh vjeneze Ave Maria një shelg në breg në qiell purpur...
Zürich See një violinë çan mjegullën si mall i motrës për mungesën
Atje poshtë rruga e shtëpisë, një portë e mbetur hapur
Ky liqe ka ngjyrën e syve të urtaku
bastun i argjendtë si thinjat në mustaqe
Atje ktheheni sa herë të doni dimër e verë...
Një erë e ngrohtë ju pret me zogjtë në jug
Ky liqe ka plot zogj të trembur që enden...
Kërkojnë lisat e varreve që lëkunden nga era
Për një fjalë të mirë të ardhjes tënde...

## A DALIM NGA ËNDRRA E KEQE DHE BËJMË DASHURI?!

Shkuan një nga një poetët që i shkruanin
ëndrrës së keqe
Natës së gjatë me gjeografi gurësh në varre
E di? Shkuan syhapur duke puthur dheun në
pëllëmbë
Me thonj të nxjerrë dhe dej gjaku në sy
Të plasur në zemër për ëndrrën e bardhë,
amanet!
E tash, a dalim nga ëndrra!?
Se "Boll Mo"... Fol...!?
Mos ma kthe kokën me një anë!
Dhe mos ma pi me fund gotën e helmit të vjetër
dymijë vjet
Ndale në zverk një pikë...
A dalim nga kjo ëndërr e keqe e zezë futë!
Ec e dalim pash mu, pash ty!
bëjmë dashuri, se sall dashuri është liria...

## AZILI IM OSE STREHA KU MBAJ NË SIRTAR ËNDRRAT E MIA

Nuk është shtëpi parmakësh me grilla bojë hiri
me lisa të mëdhenj që bëjnë hije me fllad veriu
Nuk është makinë komode me rimorkio
pushimi në verë
ku deti lag shkëmbinjtë e shpresës
Nuk është kështjellë me myshk kohësh dhe vija
thike në mur
As libër i harruar nuk është ku ka vjersha për
ujin eliksir...

As është mulli i erës se fishkëllen kohën e një dite në vjeshtë
në kodrën e vrapimit tek bari lëkundet në dashuri
Nuk është hartë ku shënjohet me kryq vendi i kutisë me ari
as lufte për Elenën ku piratohet një grua..
Sall një strehe që pret shiun e verës dhe një sirtar
me dy sy jeshile...

## MBI PULLAZ FLAMUR I VERDHË ME YJE

Tashti ti kthehesh vonë mbi pullaze antenat të kthyer në qiell
Janari i acartë flakërohet në diçka të verdhë
që gratë bëjnë yjet në shami me ojna blu
Nuk është e bardhë si qefin që burrat pështjellin kokat e thinjura..
Nuk është e kuqe si pelerina e shituar në Untergruppenbach
Me gjasë nuk ka të bëjë as me këngën "Moj e Bukura More"
As me ëndrrën e heroit të mbështjellë në kortezh
Një flamur i verdhë si ari me ngjyrë plumbi qëndron në pirg
Në fushën e mëllenjave ora e historisë i ngjan valsit vjenez
therjeve në Danub dhe letrave bizantine
gurë varesh që duken si kufij

Imzot edhe po u bashkuam nuk është Shqipëri e Madhe...

## DIMRI BALLKANIK OSE PATINAZHI I VJEDHJES

Një mëngjes me borë të rikujton fëmijërinë
Parullat K. R.* vithet e lagura dhe duart që ofshajnë ngrohtësi
hundën e dordolecit e skuqur si një diplomat nordik që vjen nga Beogradi
që lë te porta Pakon e Paqes dhe ik me kaproj të trembur
nis misioni blu - EULEKS që shkon mirë me borën...
Qentë e tredhur luajnë me bojëra kravatash
tutje një maçok i kryqëzuar evropian i ri, fle me naze
Dhe ti mbetesh vetëm, në një dhomë me plot harta dhe liberalizon kufij
fole vetë me vete për qenin e Sharrit, dardanin besnik që ruante delet...
për rrugën e kombit që duhet të përfundojë në Preshevë!
Troja bëhet këngë polifonike për vjedhjen serike,
këndojnë në kor deputetët pirat si ushunjëzat,
Atdheun e shpallin ligatinë bëjnë patinazh me vijat buxhetore...
E tash kthehemi në fillim miku im! Sërish të vonuar në orën e historisë,
mësuesi nervoz ndez cigaren, fërkon ballin

i del tymi (ka frikë se do t'i dalë flaka).
ofshan në duart e ftohta...

## KASNECI I HABERIT TË MIRË MUNGON

Thinjat po presin tek dera, si një këngë e vjetër jevgjish
Në ditarin që merr turbulencë me shkronjën e parë
një grua pret në prag të shtëpisë
kafshon buzët nga hije e bardhë..
Edhe sonte pa prijësin!
Ka vdekur kali që kullot barin e kuq të Karl Marksit të dehur
Ctrl- C i kemi bërë homazh një ëndrre të mirë
kur nga fustanella e një vajze me pikla në faqe
del virgjëria, si avujt e një kuzhine në Çikagon e viteve të 30-ta
një kasnec prej Prishtine shkarravitet në lloç për të treguar se ka një ëndërr
na rren duke qeshur... duke na treguar rrugën e shtëpisë...
As sonte nuk do të vijë hanxhiu nga qyteti që s'po bëhet dot metropol
OSBE sjell kanjusha të verdha
E ne prapë i themi Evropës kurvë e vjetër
Pa e paguar kurrë haraçin e dashurisë...

## BALLKAN EXSPRESS

Këtu uji ka rrjedhë të egër pjellë shumë histori
çdo gur shenjtëron nyje biblike dhe thotë është imi
rapsodët thyejnë dhëmbët figurat nga balta …
i bëjnë heronj i tëhollojnë deri në mazë të qepës
deri në dhembje koke i hiperbolizojnë trimëritë
epet për ushtritë që kalërojnë
sa herë dehen në këngë
dhe bëjnë kërdi derisa kthehen në tel lahute
ky vend pjell monstrum për t'i ikur lëkurës
për t'u bërë Shegert i therjes së re
vraje atë që e ke pranë se tjetër soj është
vraje dhe there se ngushtë është kjo këmishë
në cep Evrope mos harro këtu matet lashtësia me
thikë me majë të saj ndërrohen toponimet
vizatohen ura në lëkurë ku kryqëzimi bëhet në
hënë të kuqe fajësia pështillet barbarisht krejt
thonjtë gjakosen në ikje në fshehje të gjurmëve
dreq e biri i dreqit vetëm në rolin e viktimës
kupton se është kull i zotit
shkarravit pastaj harta dhe mjegull
se kush kujt i ka vjedhur gurët e varrit

## AFSH I CIFLUAR

Me gishtin tregues ciflohen koret e trungut
bien mbi pasqyrë përshkëllihen
më fal për lakuriqësinë thonë se është e vjetër
sa fundi dhe fillimi
ke ftohtë mermeri ta prek shpinën
streha pikë mbi trupin tënd vijëzon

karnavale - via Egnatia
për një jevge të bukur kallet kasabaja e Gjilanit
ky harem modern me ujëra nënshtretëror
ciflon diçka të amshueshme në botën e rrejshme
nëse më fal për lakuriqësinë
do të sqaroj në detaje...

## QUO VADIS?

S'ka dert në je ombrellë moderne
E blerë në qendër të Bernës
nga çifutja krenare që flet me zë të lartë për alkiminë
nuk prishë punë që pika e kanës në ballë të ka mbetur
në hamamin e arabit plak
që numëron virgjëreshat në kokrra tespihesh
S'ka dert në shpina jote mbështetet në mure të lagura në tokë abstrakte
Si të jesh e nëmur nga 1001 jevgë që shesin besëtytni dhe luajnë
polka me vallen tënde të dashurisë
Ti delfin i oqeanit të poetit të çmendur që
"mbrëmë fjeti me vjeshtën"
Gjumë mbretëror bën në shelgun e katedrales së Shën Gjergjit
Për një varg të çartur curril shpinës 1001 herë ia lëshon sytë dritares
Mbledh pikat e ofshamës në qelq për të larë mëkatin e ikjes...
Si pasthënie

Beqir MUSLIU
IMZOT, A TË MJAFTON KY FLIJIM
…
Çdo gjë që bëj në të vërtetë
Shkruaj një libër

E ç'të bëj tjetër
Ç'zeje të zgjedh tash
Kur veç jam i zgjedhur
Të shkruaj një libër
E libri askund nuk shkëputet
Nuk mënjanohet

Dhe kur s'kam ç'të ha
Ha një libër
Dhe kur merr fund ky procesion
Nis e libri më ha mua

Kështu deri në ditën tjetër
Dhe në ditën tjetër
Prapë prej fillimit

Libri për mua
Është metafora e Gjëllisë Sime

Imzot po ç'bëra tjetër në jetën time
Shkrova libra
Dhe kështu i radhita

Njërën mbas tjetrës…

Kurrë të kryhet i njëjti libër
Vetëm numrat ndërrohen
Libri mbetet ai i njëjti
Ai i pari i dyti i treti…
Deri në pankohësi mbase

Të shkruash libër sot
Është një vetëflijim i madh
Por ç'të bëj

Unë e kam zgjedhur këtë vetëflijim
Dhe as që ankohem
As që e refuzoj këtë realitet
Që është ky që është
Sepse unë vetë e zgjodha dhe ai u bë libër
Libri më zgjodhi mbase mua
Për të më gëlltitur për çdo ditë nga pak
Dhe në fund
Do të më bëj dhe mua Libër të Ndaluar mbase
Apo Libër Publik
Libër të Hapur

Kjo nuk varet edhe gjithaq prej meje
Për këtë vendos Hyji
Ai më dërgoi që të jem ky që jam

Dhe të jem libër

Imzot
A të mjafton ky flijim

*(Prishtinë, 17 – 18 janar 1994)*

Tahir ARIFI

## URA E POEZISË

"Parnasi me aromë Gjilani", shënjon individualitete krijuese me vokacione të ndryshme, stile, vizione dhe sensibilitet lirik që buron nga ndjeshmëri të larmishme e perceptime figurative, e që në fakt rrëfejnë mrizin e muzës së poezisë në Gjilan, vendosur në Urën e Maskatarit, këtij simboli-dëshmi të dhembjes e mbijetesës, dhe këtu e tutje shpërndan bekimin që Parnasi i ka falur Gjilanit. Dymbëdhjetë krijues, rrethuar nga katër mburoja poetike, ndërtojnë këtë libër që fjalën e figurën e bëjnë amë shpirti, nga perlat e artit të tyre shtrihen në tejkohësi, duke rrëfyer njeriun a njeriun e ambientit të tyre, dashurinë si drithërimë e dashurinë si gjakim; dheun,

atdheun historik e atdheun ideal, dhe kështu të bashkuara dalin tema e motive, ide e struktura figurative, shkolla poetike e botëkuptime të ndryshme estetiko-letrare, që zënë fill aty te Ura e Maskatarit, ku nis vargu i Mirko Gashit e shqetësohen rimat e Beqir Musliut, ku vdes "bukuria e zezë" e rilind përsëri; aty ku "dashuria kërkon rrugë për të ecur" e synon të mbushë "shportën me yje"… po, po aty ku Agimi ëndërron Lirinë, të rrëzojë atë gur e të bëhet shtatore. Pikërisht aty, Albinë Idrizi kërkon njeriun të plotësuar me dashuri, e Xhevat Latifi atë "fjalë të mirë" thënë dymijë vjet më parë, ndërsa ironizon yjet mbi blu; aty Aziz Mustafa "çmendet në letër" tek sheh vdekjen e shpirtit njerëzor, duke kërkuar dashurinë, ndërsa Avni Rudaku shpreh protestë ndaj vargut e poezisë, ndaj formalizmave e dehumanizimit. Në Urën e Maskatarit, Sabiti vazhdon rrëfimin e tij lirik për Çepurin dhe dashurinë, duke lënë mënjanë përkohësisht atë zjarrminë e dheut, ndërsa Mirusha turbullt, qindra vjet pret kthjelltësinë të shohë atdheun e Ibrahim Kadriut. Aty "tëhuajësohet" Musa Ramadani duke kërkuar miqtë, e duke ëndërruar "Vrapuesen e Prizrenit", teksa metafora e Linditës për vjeshtën mbulohet nga gjethe të verdha e të kuqërremta. Aty simbolet e Bujarit ndjejnë ankth për humbjen e përsëritjen… pikërisht aty Fehmi Ajvazi ndërton ngjyrat e rrejshme të festave e Sevdije Rexhepi bën bashkë mitet për

të kuptuar realitetin… Por, po te Ura e Maskatarit është ulur këmbëkryq Ramadan Mehmeti dhe rigjen gjurmët e kohës… Kështu "Parnasi me aromë Gjilani", bëhet Gjilani vetë, shpirti i gjallë e i vdekur i tij, i dashuruar e i tradhtuar, i dehumanizuar a çmendur, kërkues e i revoltuar… aty ku ka nisur me Rexhën, Beqën e Mirkon – te Ura e Maskatarit. Breza të ndryshëm poetësh, përmes "Parnasit me aromë Gjilani", ndërtojnë Urën e Poezisë, të cilën nuk e kalojmë dot pa e shijuar!

---

PËRMBAJTJA

Rexhep Elmazi: Për shokun tim që këndon
( pjesa e pare, e thyer e kopertinës)
Mirko Gashi: Në vend të parathënies: Ura e Maskatarit, 5
Albina Idrizi, 8
Avni Rudaku, 21
Aziz Mustafa, 35
Bujar Salihu, 48
Fehmi Ajvazi, 63
Ibrahim Kadriu, 77
Linditë Ramushi, 96
Musa Ramadani, 109
Ramadan Mehmeti, 124
Sabit Rrustemi, 139
SevdijeRexhepi, 155
Xhevat Latifi, 167

Beqir Musliu: Në vend të pasthënies:  Imzit, a të mjafton ky flijim
Tahir Arifi: Ura e poezisë, 182
Agim Ramadani: Në mungesën time
(pjesa e prapme e thyer e kopertinës)

Grup Autorësh
PARNASI ME AROMË GJILANI
Përkujdesja teknike
Ars Clubi "Beqir Musliu"

* * *

© Pashtriku.org, Janar 2013